



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr. 57**

**23 maj**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 267, datë 12.4.2012	Për llojet dhe mënyrën e shkëmbimit e të përpunimit të informacionit e të të dhënave statistikore të kërkuara nga ASHMDF-ja e nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor.....	2843
Udhëzim i METE nr.1, datë 30.4.2012	Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të aplikimeve për marrjen e lejeve ndërtimore për objekte të natyrës energjetike dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe, si dhe për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për dhënien e këtyre lejeve.....	2855
Urdhër i MASH nr. 154, datë 13.4.2012	Për hapjen e njësisve kryesore pranë shkollës së lartë private “Vitrina”.....	2858
Urdhër i MASH nr. 187, datë 7.5.2012	Për hapjen e Fakultetit të Infermierisë në universitetin “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit.....	2859
Vendim i GJK nr.27, datë 9.5.2012	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.5, datë 1.3.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	2860
Vendim i ERE nr. 39, datë 23.4.2012	Për miratimin e udhëzuesit për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve në projektin “Trans Adriatik Pipeline (TAP)”, sipas paragrafit 6 të nenit 36 të direktivës 2009/73/EC.....	2872
Vendim i KKRT nr. 62, datë 13.4.2012	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Ora News”.....	2878
Vendim i KKRT nr. 63, datë 13.4.2012	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Kiss”.....	2878
Vendim i KKRT nr. 64, datë 13.4.2012	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Spartak SM”.....	2879

**VENDIM**  
**Nr. 267, datë 12.4.2012**

**PËR LLOJET DHE MËNYRËN E SHKËMBIMIT E TË PËRPUNIMIT TË INFORMACIONIT E TË TË DHËNAVE STATISTIKORE TË KËRKUARA NGA ASHMDF-JA E NGA STRUKTURAT SHTETËRORE PËRGJEGJËSE, NË NIVEL QENDROR DHE VENDOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 37 të ligjit nr. 10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Monitorimi i treguesve të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës realizohet në nivel, qendror dhe vendor, me qëllim mundësimin e të dhënave për hartimin e rekomandimeve dhe të politikave për mbështetjen e programeve të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.

2. Ministritë e linjës/institucionet qendrore i dërgojnë Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (ASHMDF) të dhënat statistikore të mbledhura dhe të përpunuara, bazuar në formularët që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe periodicitetit të përcaktuar në to.

3. Strukturat vartëse të ministrive të linjës, në nivel vendor, i dërgojnë njësisë për të drejtat e fëmijës në qark, të dhënat statistikore për rajonin, bazuar në formularët, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe periodicitetit të përcaktuar në to. Njësia për të drejtat e fëmijës në qark përpunon të dhënat e të gjitha institucioneve në nivel vendor dhe, brenda muajit pasardhës, ia dërgon ASHMDF-së.

4. Instituti i Statistikës (INSTAT), me kërkesë të ASHMDF-së, i dërgon kësaj të fundit të dhënat statistikore, të përcaktuara në formularët që i bashkëlidhen këtij vendimi.

5. ASHMDF-ja mbledh dhe përpunon të dhënat statistikore, të dërguara nga strukturat dhe institucionet e parashikuara në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi dhe, pasi i vlerëson, harton raporte periodike për realizimin e qëllimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, me synim përmirësimin e respektimit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.

6. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dërgon pranë sektorit të statistikës të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të dhënat e mbledhura.

7. Ngarkohet Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



**TREGUESIT DEMOGRAFIKË**

Treguesi	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Periodiciteti i mbledhjes së të dhënave
1. Numri dhe % e fëmijëve sipas: - grupmoshës; - gjinisë; - qarqeve.	Numër dhe përqindje	INSTAT	vjetor
2. Numri i familjeve sipas: - numrit të anëtarëve; - qarqeve.	Numër familjesh	INSTAT	vjetor
3. Numri i familjeve me fëmijë nën 18 vjeç të ndarë sipas: - numrit të fëmijëve; - qarqeve.	Numër familjesh	INSTAT	vjetor
4. Numri i familjeve me fëmijë të moshës deri 18 vjeç që mbështeten me ndihmë ekonomike, sipas qarqeve.	Numër	SHSSH SHSSH rajonal	vjetor
5. Numri i fëmijëve nën 18 vjeç që jetojnë me 1 prind sipas qarqeve.	Numër	INSTAT	vjetor
6. Numri i familjeve me fëmijë të moshës 0-18 vjeç, me kryefamiljare gra që mbështeten me ndihmë ekonomike sipas qarqeve.	Numër	SHSSH SHSSH rajonal	vjetor
7. Numri i fëmijëve të moshës 6-15 vjeç që vazhdojnë arsimin e detyruar dhe jetojnë në familje që trajtohen me ndihmë ekonomike.	Numër	SHSSH SHSSH rajonal	vjetor

**TREGUESIT E VARFËRISË PËR FËMIJËT**

Treguesi	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Periodiciteti i mbledhjes së të dhënave
1. Përqindja e fëmijëve të varfër (nën 18 vjeç) ndaj numrit të fëmijëve gjithsej sipas: - gjinisë; - urban/rural; - gjinisë së kryefamiljarit.	Përqindje	INSTAT	vjetor LSMS
2. Shkalla e varfërisë absolute sipas grupmoshave: - Numrit të fëmijëve (nën 18 vjeç) në familje.	Përqindje	INSTAT	vjetor LSMS
3. Shkalla e varfërisë absolute sipas gjinisë.	Përqindje	INSTAT	vjetor

			LSMS
4. Shkalla e varfërisë absolute sipas nivelit arsimor të kryefamiljarit.	Përqindje	INSTAT	vjetor LSMS
5. Shkalla e varfërisë absolute sipas zonës urbane/rurale.	Përqindje	INSTAT	vjetor LSMS
6. Shkalla e varfërisë absolute sipas numrit të fëmijëve (nën 18 vjeç) në familje.	Përqindje	INSTAT	vjetor LSMS

Formulari nr. 3

### TREGUESIT E PËRKUJDESIT SOCIAL

Treguesi	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Periodiciteti i mbledhjes së të dhënave
1. Llojet e shërbimeve për fëmijë sipas qarqeve.	Cilësor	SHSSH SHSSH rajonal	vjetor
2. Numri i fëmijëve që përfitojnë shërbime sociale sipas: - llojit të shërbimit; - qarqeve.	Numër	SHSSH SHSSH rajonal	vjetor
3. Numri i institucioneve për fëmijë të ndarë: - publike; - private sipas njësive të pushtetit vendor që i administrojnë.	Numër	SHSSH SHSSH rajonal	vjetor
4. Numri i fëmijëve të vendosur në institucionet rezidenciale publike e private, sipas llojit të institucionit: - institucion rezidencial për fëmijë; - institucion rezidencial zhvillimi; - qendra për viktimat e trafikimit; - qendra pritëse.	Numër	SHSSH SHSSH rajonal Drejtoria e shërbimeve sociale bashki/komunë	vjetor
5. Numri i fëmijëve në institucionet rezidenciale publike e private, sipas: - grupmoshës; - gjinisë; - rreme; - qarqe.	Numër	SHSSH SHSSH rajonal Drejtoria e shërbimeve sociale bashki/komunë	vjetor
6. Numri i fëmijëve që hyjnë në institucionet rezidenciale publike e private sipas: - grupmoshës; - gjinisë; - rreme.	Numër	SHSSH SHSSH rajonal Drejtoria e shërbimeve sociale bashki/komunë	vjetor
7. Numri i fëmijëve që dalin nga institucionet rezidenciale publike e private sipas:	Numër	SHSSH	vjetor



- grupmoshës; - arsyes së largimit.		SHSSH rajonal Drejtoria e shërbimeve sociale bashki/komunë	
8. Numri i fëmijëve në institucionet rezidenciale publike e private sipas kohëzgjatjes së qëndrimit në institucion (më pak se 1 vit, 1-2 vjet....më shumë se 10 vjet).	Numër	SHSSH SHSSH rajonal Drejtoria e shërbimeve sociale bashki/komunë	vjetor
9. Numri i fëmijëve në institucionet rezidenciale publike e private sipas statusit ligjor të tyre (i braktisur, jetim etj.)	Numër	SHSSH SHSSH rajonal Drejtoria e shërbimeve sociale bashki/komunë	vjetor
10. Kapaciteti, numri i fëmijëve që jetojnë në institucion rezidencial publik e privat dhe % e shfrytëzimit të kapacitetit të institucionit rezidencial për fëmijë, sipas njësisë së qeverisjes vendore.	Numër dhe përqindje	SHSSH SHSSH rajonal Drejtoria e shërbimeve sociale bashki/komunë	vjetor
<b>Aftësia e kufizuar</b>			
11. Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar sipas: - llojit të aftësisë së kufizuar; - grupmoshave; - gjinisë; dhe - qarqeve.	Numër	SHSSH SHSSH rajonal	vjetor
<b>Kujdestaria</b>			
12. Numri i familjeve kujdestare sipas njësive të qeverisjes vendore.	Numër	SHSSH SHSSH rajonal	vjetor
13. Numri i fëmijëve të vendosur në kujdestari sipas: - njësive të qeverisjes vendore; - grupmoshave; - gjinisë; - rome; - sipas strukturës së familjes kujdestare; - arsyeve të vendosjes së fëmijëve në kujdestari.	Numër	SHSSH SHSSH rajonal	vjetor
14. Numri i fëmijëve të vendosur në kujdestari, pranë familjeve kujdestare që kanë lidhje gjaku me fëmijën.	Numër	SHSSH SHSSH rajonal	vjetor
15. Numri i fëmijëve që kanë ndërprerë shërbimin e kujdestarisë sipas: - njësive të qeverisjes vendore; - shkakut (kthim në familjen biologjike, kthim në institucion, vendosje në një familje tjetër kujdestare, jetesës së pavarur, vendosje a një lloj shërbimi tjetër, birësim etj. ).	Numër	SHSSH SHSSH rajonal	vjetor
<b>Birësimi</b>			

16. Numri i fëmijëve që me vendim gjykate janë shpallur “të braktisur”.	Numër	MD	vjetor
17. Numri i fëmijëve për të cilët kanë filluar procedurat e birësimit, sipas: - grupmoshave; - gjinisë; - etnisë; - qarqeve.	Numër	Komiteti i Birësimit	vjetor
18. Numri i fëmijëve të birësuar sipas: - grupmoshave; - gjinisë; - etnisë; - brenda dhe jashtë vendit.	Numër	Komiteti i Birësimit	vjetor
19. Numri i fëmijëve të birësuar sipas strukturës së familjes birësuese.	Numër	Komiteti i Birësimit	vjetor
20. Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar, të birësuar brenda dhe jashtë vendit.	Numër	Komiteti i Birësimit	vjetor
21. Kohëzgjatja mesatare që nga momenti kur fëmija shpallet “i braktisur” deri në momentin kur fillojnë procedurat e birësimit.	Muaj	Komiteti i Birësimit	vjetor
22. Kohëzgjatja mesatare që nga momenti kur fillojnë procedurat e birësimit deri në birësimin e fëmijës.	Muaj	Komiteti i Birësimit	vjetor
23. Kohëzgjatja mesatare që nga momenti kur fëmija shpallet “i braktisur” deri në momentin kur birësohet.	Muaj	Komiteti i Birësimit	vjetor

Formulari nr. 4

#### TREGUESIT SHËNDETËSORË

Treguesi	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Periodiciteti i mbledhjes së të dhënave
<b>Vdekshmëria</b>			
1. Numri i fëmijëve të lindur gjallë, sipas gjinisë dhe qarqeve.	Numër	MSH	vjetor
2. Numri i fëmijëve të vdekur deri në moshën 1 vjeç, sipas gjinisë.	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile	vjetor
3. Vdekshmëria foshnjore (numri i vdekjeve të fëmijëve deri 1 vjeç/1000 lindje gjallë) sipas gjinisë.	Numër për një mijë	INSTAT, MSH	vjetor
4. Vdekshmëria foshnjore në periudhën neonatale (numri i fëmijëve 0-28 ditësh të vdekur/1000 lindje gjallë) sipas gjinisë	Numër për një mijë	MSH, INSTAT	vjetor
5. Vdekshmëria e fëmijëve nën 5 vjeç (numri i fëmijëve të vdekur deri në moshën 5 vjeç/1000 lindje gjallë) sipas gjinisë.	Numër për një mijë	INSTAT	vjetor
6. Numri i vdekjeve të fëmijëve 1-5 vjeç sipas shkaqeve të vdekjes (pneumonia, diarreja, HIV/AIDS, aksidente etj.).	Numër	INSTAT	vjetor
7. Vdekshmëria amenore (numri vdekjeve të grave shtatzënë, grave deri në 42 ditë pas	Numër për një qind mijë	INSTAT, MSH	vjetor



lindjes e / 100,000 lindje gjallë).			
<b>Sëmundshmëria</b>			
8. Numri, përqindja e fëmijëve me simptoma të ARI (Acute Respiratory Infections), që kanë marrë kujdesin e nevojshëm shëndetësor.	Numër dhe përqindje	INSTAT, MSH	Survejime 5-vjeçare si SDSHSH-Studim Demografik Kombëtar Shëndetësor Shqiptar (DHS)
9. Numri, përqindja e fëmijëve me diarre që marrin trajtimin dhe ushqimin e nevojshëm.	Numër dhe përqindje	INSTAT, MSH	Survejime 5-vjeçare si SDSHSH-Studim Demografik Kombëtar Shëndetësor Shqiptar (DHS)
<b>Ushqimi</b>			
10. Numri dhe % e fëmijëve të lindur nën peshë sipas gjinisë.	Numër dhe përqindje	MSH	vjetor
11. Përqindja e fëmijëve që ushqehen me qumësht gjiri sipas: - grupmoshave; - gjinisë; - qarqeve.	Përqindje	MSH	vjetor
12. Përqindja e fëmijëve deri 5 vjeç të kequshqyer (pesha, gjatësia, peshë për gjatësi) sipas: - grupmoshave; - gjinisë; - karakteristikave socio-ekonomike; - qarqeve.	Përqindje	INSTAT, MSH	Survejime 5-vjeçare si p.sh. SDSHSH-Studim Demografik Kombëtar Shëndetësor Shqiptar MICS
13. Përqindja e fëmijëve deri 5 vjeç mbipeshë sipas: - grupmoshave; - gjinisë; - karakteristikave socio-ekonomike; - qarqeve.	Përqindje	INSTAT, MSH	Survejime 5-vjeçare si p.sh. SDSHSH-Studim Demografik Kombëtar Shëndetësor Shqiptar MICS
14. Prevalenca e mungesës së jodit te fëmijët dhe gratë shtatzëna. Konsumi i kripës së jodizuar.	Përqindje	INSTAT, MSH	Survejime 5-vjeçare si p.sh. SDSHSH-Studim Demografik Kombëtar Shëndetësor Shqiptar MICS
<b>Imunizimi</b>			

15. Përqindja e fëmijëve deri 1 vit të imunizuar me të gjitha vaksinat e përcaktuara në skemën e vaksinimit.	Përqindje	ISHP, MSH	vjetor
16. Përqindja e fëmijëve deri 1 vit të imunizuar me 1 dozë BCG.	Përqindje	ISHP, MSH	vjetor
17. Përqindja e fëmijëve deri 1 vit të imunizuar me 1 dozë për fruthin.	Përqindje	ISHP, MSH	vjetor
18. Përqindja e fëmijëve deri 1 vit të imunizuar me 3 doza DTP.	Përqindje	ISHP, MSH	vjetor
19. Përqindja e fëmijëve deri 1 vit të imunizuar me 3 doza Hepatitis B.	Përqindje	ISHP, MSH	vjetor
20. Përqindja e fëmijëve deri 1 vit të imunizuar me 3 doza Polio.	Përqindje	ISHP, MSH	vjetor
<b>KUJDESI PËR NËNËN</b>			
21. Numri dhe përqindja e lindjeve të asistuara nga staf profesional.	Numër dhe përqindje	INSTAT, MSH	vjetor
22. Përqindja e grave shtatzëna që kryejnë të paktën 1 vizitë te mjeku gjatë kohës së shtatzanisë.	Përqindje	MSH	vjetor
23. Numri dhe përqindja e vajzave deri 18 vjeç që kanë lindur fëmijë.	Përqindje	INSTAT	vjetor
<b>HIV/AIDS</b>			
24. Numri dhe përqindja e fëmijëve të sëmurë me HIV/AIDS.	Numër dhe përqindje	ISHP, MSH	vjetor
25. Numri i grave shtatzana të sëmura me HIV/AIDS.	Numër dhe përqindje	ISHP, MSH	vjetor
26. Numri i fëmijëve me HIV/AIDS që trajtohen.	Numër	ISHP, MSH	vjetor
27. Numri i fëmijëve që i ka vdekur njeri ose të dy prindërit nga HIV/AIDS.	Numër	ISHP, MSH	vjetor
<b>Planifikimi familjar</b>			
28. Përqindja e femrave 15-49 vjeç që kanë njohuri për të paktën 2 mënyra të planifikimit familjar.	Përqindje	INSTAT, MSH	Survejime 5-vjeçare si p.sh. SDSHSH-Studim Demografik Kombëtar Shëndetësor Shqiptar.
29. Përqindja e femrave 15-49 vjeç që përdorin 1 mënyrë të planifikimit familjar.	Përqindje	INSTAT, MSH	Survejime 5-vjeçare si p.sh. SDSHSH-Studim Demografik Kombëtar Shëndetësor Shqiptar





**TREGUESIT E DHUNËS, TRAFIKIMIT, GJAKMARRJES DHE MBROJTJES**

<b>Treguesi</b>	<b>Njësia e matjes</b>	<b>Burimi i të dhënave</b>	<b>Periodiciteti i mbledhjes së të dhënave</b>
<b>Vetëvrasjet e fëmijëve</b>			
1. Numri dhe përqindja e vetëvrasjeve të fëmijëve sipas: - gjinisë; - shkakut të vetëvrasjes.	Numër dhe përqindje	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	vjetor
2. Numri i tentativave për vetëvrasje të fëmijëve sipas: - gjinisë; - shkakut.	Numër dhe përqindje	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	vjetor
<b>Aksidentet rrugore</b>			
3. Numri i fëmijëve të vdekur në aksidentet rrugore sipas gjinisë.	Numër dhe përqindje	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	vjetor
4. Numri i fëmijëve të plagosur në aksidentet rrugore sipas gjinisë.	Numër dhe përqindje	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	vjetor
<b>Trafikimi</b>			
1. Numri i fëmijëve të trafikuar, sipas: - grupmoshave; - gjinisë; - vendbanimit; - arsimimit; - etnisë; - kombësisë.	Numër	MB	vjetor
2. Numri i fëmijëve të trafikuar sipas shërbimeve të ofruara.	Numër	MB	vjetor
3. Numri i fëmijëve të ritrafikuar.	Numër	MB	vjetor
4. Numri i fëmijëve të trafikuar që marrin pjesë si dëshmitarë në proceset gjyqësore të trafikanteve të tyre.	Numër	MB	vjetor
<b>Mbrojtja e fëmijëve</b>			
5. Numri i dosjeve të hapura në njësinë vendore për fëmijët në rrezik, sipas: - bashkisë/komunës; - grupmoshës; - gjinisë; - etnisë.	Numër	Njësitë për mbrojtjen e fëmijëve bashki/komunë	mars qershor shtator dhjetor

6. Numri total i fëmijëve të referuar nga njësia e mbrojtjes së fëmijëve në struktura të tjera.	Numër	Njësitë për mbrojtjen e fëmijëve bashki/komunë	mars qershor shtator dhjetor
7. Numri i rasteve të fëmijëve në situata emergjente të menaxhuara nga njësia e mbrojtjes së fëmijëve.	Numër	Njësitë për mbrojtjen e fëmijëve bashki/komunë	mars qershor shtator dhjetor
8. Numri i rasteve të menaxhuara: - raste te reja; - raste ne total (duke përfshirë ato të hapura më parë).	Numër	Njësitë për mbrojtjen e fëmijëve bashki/komunë	mars qershor shtator dhjetor
9. Numri i vizitave të kryera në familje.	Numër	Njësitë për mbrojtjen e fëmijëve bashki/komunë	mars qershor shtator dhjetor
10. Numri i dosjeve të mbyllura.	Numër	Njësitë për mbrojtjen e fëmijëve bashki/komunë	mars qershor shtator dhjetor
<b><i>Dhuna, abuzimi</i></b>			
1. Numri i fëmijëve që kanë pësuar dhunë, sipas: - qarqeve; - grupmoshave; - gjinisë.	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	vjetor
2. Numri i denoncimeve tek autoritetet dhe numri personave të ndaluar për dhunë, abuzim, ndaj të miturve.	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	vjetor
3. Numri i fëmijëve viktimë sipas llojit të dhunës: - dhunë në familje; - shfrytëzim seksual; - keqtrajtim; - trafikim.	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	vjetor
4. Dhunuesit sipas lidhjes që kanë me viktimën.	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	vjetor
5. Numri i rasteve kur është dënuar apo ka filluar ndjekja penale ndaj autorit të krimit.	Numër	MD	vjetor



**TREGUESIT E DREJTËSISË PËR TË MITURIT**

<b>Treguesi</b>	<b>Njësia e matjes</b>	<b>Burimi i të dhënave</b>	<b>Periodiciteti i mbledhjes së të dhënave</b>
1. Numri i fëmijëve të denoncuar sipas: - llojit të veprës së kryer; - vendbanimit.	Numër	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	vjetor
2. Përqindja e fëmijëve të denoncuar në krahasim me totalin e denoncimeve.	Përqindje	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	vjetor
3. Numri i fëmijëve të dënuar sipas: - llojit të veprës së kryer; - gjinisë; - masës së dënimit; - nivelit të arsimit.	Numër	MD	vjetor
4. Numri dhe përqindja e fëmijëve të dënuar në krahasim me totalin e dënimeve.	Përqindje	MD	vjetor
5. Numri i fëmijëve në paraburgim dhe burgje sipas: - llojit të veprës penale; - gjinisë.	Numër	MD, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	vjetor
6. Numri i fëmijëve që marrin dënime alternative sipas: - llojit të veprës penale; - gjinisë.	Numër	MD	vjetor

**TREGUESIT E PUNËSIMIT TË FËMIJËVE**

<b>Treguesi</b>	<b>Njësia e matjes</b>	<b>Burimi i të dhënave</b>	<b>Periodiciteti i mbledhjes së të dhënave</b>
1. Numri i fëmijëve ekonomikisht aktivë që janë të punësuar sipas: - grupmoshës; - gjinisë; - qarqeve; - llojit të sektorit ekonomik; - arsimit.	Numër	ISHP	vjetor
2. Numri i fëmijëve ekonomikisht aktivë që punojnë në një biznes familjar sipas: - grupmoshës; - gjinisë; - qarqeve;	Numër	INSTAT	Child Labour Survey

- llojit të sektorit ekonomik; - arsimimit.			
3. Numri i inspektimeve të kryera në vende pune ku punojnë të mitur sipas rajonit.	Numër	ISHP	vjetor
4. Numri i gjobave të vendosura ndaj subjekteve, për shkeljet në punësimin e të miturve.		ISHP	vjetor
5. Numri i fëmijëve që kanë pësuar aksidente në punë sipas: - industrisë; - llojit të punës që punonin; - grupmoshës; - gjinisë.	Numër	ISHP	vjetor
6. Numri i fëmijëve të përfshirë në format më të këqija të punës sipas: - llojit të punës; - gjinisë; - grupmoshave; - qarqeve; - etnisë; - orëve të punës; - frekuentimit të shkollës.	Numër	INSTAT	Child Labour Survey

Formulari nr. 8

**TREGUESIT E ARSIMIMIT TË FËMIJËVE**

Treguesi	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Periodiciteti i mbledhjes së të dhënave
<b>Edukimi</b>			
1. Numri total dhe përqindja e nxënësve që përfundojnë arsimin fillor sipas: - qarqeve; - gjinisë.	Numër dhe përqindje	MASH DAR/ZA	vjetor
2. Përqindja e fëmijëve 6-7 vjeç që janë regjistruar në klasën e parë në krahasim me numrin total të fëmijëve 6-7 vjeç sipas gjinisë (Net Enrolment Ratio, NER).	Përqindje	INSTAT	vjetor
3. Përqindja e fëmijëve të regjistruar në klasë të parë në krahasim me numrin total të fëmijëve 6-7 vjeç sipas: - gjinisë (Gross Enrolment Ratio, GER).	Përqindje	INSTAT	vjetor
4. Numri i fëmijëve në klasë në ciklin e ulët.	Numër	MASH DAR/ZA	vjetor
5. Raporti nxënës/mësues në ciklin e ulët sipas vendndodhjes.	Përqindje	MASH DAR/ZA	vjetor
6. Përqindja e fëmijëve të regjistruar në arsimin 9-vjeçar në krahasim me numrin total	Përqindje	INSTAT	vjetor



të fëmijëve 11-14 vjeç sipas: - gjinisë (Gross Enrolment Ratio, GER).			
7. Numri i fëmijëve në klasë në ciklin e ulët dhe ciklin e lartë në arsimin 9-vjeçar.	Numër	MASH DAR/ZA	vjetor
8. Raporti nxënës /mësues në ciklin e ulët dhe ciklin e lartë në arsimin 9-vjeçar.	Përqindje	MASH DAR/ZA	vjetor
9. Numri i mësuesve në ciklin e ulët dhe ciklin e lartë në arsimin 9-vjeçar sipas gjinisë.	Numër	MASH DAR/ZA	vjetor
10. Indeksi i barazisë gjinore në ciklin e ulët dhe ciklin e lartë në arsimin 9-vjeçar (NER vajza/NER djem).	Përqindje	INSTAT, MASH	vjetor
11. Përqindja e braktisjes shkollore sipas: - gjinisë; - qarqeve; - ciklit të arsimit.	Përqindje	MASH DAR/ZA	vjetor
12. Regjistrimet në shkollat publike e private sipas ciklit 9-vjeçar dhe të mesëm.	Numër	INSTAT, MASH DAR/ZA	vjetor
13. Numri dhe përqindja e nxënësve përsëritës sipas nivelit: - të arsimit; - të gjinisë; - të qarqeve.	Numër dhe përqindje	INSTAT, MASH DAR/ZA	vjetor
14. Numri: - i shkollave; - i nxënësve; - i mësuesve sipas qarqeve.	Numër	MASH	vjetor
<b>Kopshte dhe çerdhe</b>			
15. a) Numri i çerdheve sipas qarqeve; b) Numri i kopshteve sipas qarqeve; c) Numri i edukatorëve sipas qarqeve.	Numër	Bashkitë, MASH	vjetor
16. Numri i fëmijëve 0-3 vjeç që shkojnë në çerdhe, sipas: - gjinisë; - qarqeve.	Numër	Bashkitë	vjetor
17. Raporti fëmijë/edukator në: a) çerdhet; b) kopshtet publike e private.	Përqindje	Bashkitë, MASH	vjetor
18. Përqindja e fëmijëve 3-6 vjeç që shkojnë në kopsht në krahasim me numrin total të fëmijëve 3-6 vjeç, sipas gjinisë.	Përqindje	INSTAT, MASH	vjetor

## UDHËZIM

Nr. 1, datë 30.4.2012

### **PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË APLIKIMEVE PËR MARRJEN E LEJEVE NDËRTIMORE PËR OBJEKTE TË NATYRËS ENERGJETIKE DHE OBJEKTE ME RREZIKSHMËRI TË LARTË TË KËSAJ FUSHE, SI DHE PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR DHËNIEN E KËTYRE LEJEVE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1/b 1 të nenit 72, pikës 2 të nenit 76, nenit 78 dhe nenit 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, si dhe të pikës 1/b të nenit 12 dhe pikës 2 të nenit 18 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 13.7.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar,

#### UDHËZOJ:

1. Trajtimi dhe përpunimi paraprak i kërkesës së subjektit që paraqet në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) një aplikim për marrje leje për punime ndërtimore objektesh të natyrës energjetike dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe, bëhet nga njësia përkatëse në METE që mbulon fushën e aktivitetit për objektet për të cilat është paraqitur kërkesa dhe aplikimi përkatës, pasi më parë nga ana e subjektit të jetë bërë pagesa për “Tarifën e aplikimit” (e përcaktuar në përmbushje të kërkesës së germës C të formularit TIP 1 “Kërkesë për kryerje punimesh”, shtojca 2 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 13.7.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”. “Fatura e pagesës për tarifën e aplikimit”).

Vlera e tarifës së aplikimit është 150 000 lekë, pavarësisht nga lloji i objektit të natyrës energjetike apo i objektit me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe, për të cilën kërkohet leja për punime ndërtimore.

2. Për shqyrtimin e kërkesave dhe të aplikimeve përkatëse, për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektesh të natyrës energjetike dhe objekteve me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe ngrihet “Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektesh të natyrës energjetike dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe”, me përbërje si më poshtë:

- |  |         |
|--|---------|
| - Z.Illirjan Muho (METE)               | Kryetar |
| - Z.Stavri Dhima (METE)                | anëtar  |
| - Z.Zamir Stefani (METE)               | anëtar  |
| - Znj.Fatbardha Osmani (METE)          | anëtare |
| - Z.Ilia Gjermani (METE)               | anëtar  |
| - Z.Arvid Uruçi (METE)                 | anëtar  |
| - Znj.Pranvera Dokle (SHGJSH)          | anëtare |
| - Znj.Enkelejda Arizaj (AKBN)          | anëtare |
| - Znj.Rezarta Golemi (Albpetrol sh.a.) | anëtare |
| - Z.Llambi Rumnici (Albpetrol sh.a.)   | anëtar  |
| - Z.Dëfrim Xhemali (KESH sh.a.)        | anëtar  |

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektesh të natyrës energjetike dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe, mblidhet me kërkesë të kryetarit, sa herë që kërkohet shqyrtimi i praktikave për dhënie leje për punime në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar.

Në njoftimin e dhënë nga kryetari, jepet edhe agjenda e mbledhjes së komisionit, si dhe vendi, data dhe ora e zhvillimit të mbledhjes.

Mbledhja e komisionit zhvillohet vetëm në rast se janë prezent më shumë se 2/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të komisionit.

Kryetari i komisionit cakton një person në rolin e sekretarit të këtij Komisioni.

3. Për çdo aplikim të paraqitur në METE për marrje leje për punime ndërtimore për objekte të natyrës energjetike dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe, njësia e METE-s që mbulon



fushën e aktivitetit energjetik përkatës për objektet për të cilat është paraqitur kërkesa dhe aplikimi nga subjekti i interesuar për marrje leje për punime ndërtimore, brenda 10 ditëve bën verifikimin e përmbushjes në formë të kërkesave për dokumentacionin e paraqitur nga subjekti aplikues.

Pjesë e dokumentacionit të dorëzuar nga aplikuesi për marrje leje për punime ndërtimore duhet të jetë edhe dokumenti i planit të vendosjes së ndërtimit, i cili duhet të jetë i miratuar paraprakisht nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore që ka nën juridiksion zonën e vendndodhjes së strukturës që do ndërtohet. Plani i vendosjes së ndërtimit përmban planin e vendosjes së strukturës ndërtimore, lidhjen e strukturës me infrastrukturën në zonë, si dhe pozicionin e saj në kuadër të planit të miratuar (në rast se ekzistenca e këtij plani është kërkesë e planifikimit të integruar).

Nëse dokumentacioni nuk është i plotë, subjekti njoftohet duke i lënë një afat 30-ditor për plotësimin e mangësive.

Nëse dokumentacioni është i plotë, kërkesa dhe dokumentacioni shoqëruet i këtij aplikimi, nëpërmjet kryetarit të komisionit për shqyrtimin e kërkesave për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektsh të natyrës energjetike dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe, përcillen në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT) për vlerësim dhe pasqyrim në regjistër, si dhe për marrje mendimi oponent nga institucione ose ekspertë të fushës.

4. Njësia përkatëse në METE që mbulon fushën e aktivitetit energjetik përkatës për objektet për të cilat është paraqitur kërkesa dhe aplikimi përkatës për marrje leje për punime ndërtimore, me miratim të kryetarit të komisionit për shqyrtimin e kërkesave për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektsh të natyrës energjetike dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe bën afishimin në faqen zyrtare të *web* të METE të njoftimit për kërkesën dhe aplikimin e paraqitur për marrje leje për punime ndërtimore, duke lënë një afat 10 ditë për shprehje të vërejtjeve, propozimeve ose pretendimeve për këtë aplikim, nga çdo autoritet kombëtar dhe/ose vendor i interesuar, si dhe palë e interesuar për aplikimin.

5. Përgatitja e dosjes, si dhe e raportit shoqëruet për përmbushjen në formë të kërkesave të aplikimit, të cilat do të paraqiten në komision, bëhen nga njësia e METE-s që mbulon fushën e aktivitetit energjetik përkatës për objektet për të cilat është paraqitur kërkesa dhe aplikimi nga subjekti i interesuar për marrje leje për punime ndërtimore, pasi për këtë aplikim të jetë marrë vlerësimi dhe pasqyrimi i bërë në regjistër nga AKPT, si dhe të jetë marrë mendimi oponent nga institucione ose ekspertë të fushës.

Kopja e dokumentit të planit të vendosjes së ndërtimit, që përmban planin e vendosjes së strukturës ndërtimore, lidhjen e strukturës me infrastrukturën në zonë, si dhe pozicionin e saj në kuadër të planit territorial (në rast se ekzistenca e këtij plani është kërkesë e planifikimit të integruar), azhurnohet nga sektori/eksperti i GIS në përbërje ose vartësi të METE.

6. Dokumenti i lejes për punime ndërtimore të natyrës energjetike dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe (sipas llojit të lejes/lejeve, sikurse është kërkuar nga subjekti aplikues), që plotësohet në dy kopje origjinale nga ana e njësisë së METE-s që ka trajtuar aplikimin e subjektit për marrje leje për punime, si dhe dokumenti i planit të vendosjes së ndërtimit, që përmban planin e vendosjes së strukturës ndërtimore, lidhjen e strukturës me infrastrukturën në zonë, si dhe pozicionin e saj në kuadër të planit të miratuar (në rast se ekzistenca e këtij plani është kërkesë e instrumentit të planifikimit), janë pjesë e dosjes që bashkëshoqëron praktikën që dorëzohet në komision, duke vënë në dijeni kryetarin e komisionit.

7. Mbledhja e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektsh të natyrës energjetike dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe, bëhet jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e dosjes me të gjitha materialet dhe dokumentacionin përkatës që lidhen dhe janë në plotësim të kërkesës së paraqitur nga subjekti për marrjen e lejes për punime ndërtimi, përfshirë edhe vlerësimin nga AKPT, si dhe mendimin oponent nga institucione ose ekspertë të fushës.

8. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektsh të natyrës energjetike dhe objekte me rrezikshmëri të lartë në këtë fushë, bën trajtimin e çështjeve si më poshtë:

a) Shqyrton kërkesat për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektsh të natyrës energjetike dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe, duke bërë:

i) kontrollin e rregullshmërisë nga pikëpamja teknike të dokumentacionit që shoqëron aplikimin;  
ii) vlerësimin e përputhshmërisë për leje për punime ndërtimi me instrumentet e planifikimit mbi bazën e praktikave dhe të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga njësia përkatëse në METE, që mbulon fushën e aktivitetit energjetik përkatës për objektet për të cilat është paraqitur kërkesa dhe aplikimi përkatës për marrje leje për punime ndërtimore.

b) Mbi bazën e vlerësimit nga anëtarët e komisionit, si dhe duke pasur në konsideratë vlerësimin nga AKPT-ja, po ashtu edhe mendimin oponent nga institucione ose ekspertë të fushës, komisioni merr vendimin për:

i) pranim të kërkesë dhe aplikimit përkatës dhe për paraqitjen në dy kopje origjinale te ministri për miratim (firmosje) të dokumentit të lejes për punime ndërtimi, sipas llojit të lejes/lejeve, sikurse është kërkuar nga subjekti aplikues, si dhe të dokumentit të planit të vendosjes së ndërtimit, që përmban planin e vendosjes së strukturës ndërtimore, lidhjen e strukturës me infrastrukturën në zonë, si dhe pozicionin e saj në kuadër të planit të miratuar (në rast se ekzistenca e këtij plani është kërkesë e instrumentit të planifikimit) të firmosur paraprakisht nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore që ka nën juridiksion zonën e vendndodhjes së strukturës që do të ndërtohet;

ii) pranim të kërkesës dhe aplikimit përkatës dhe për përcjellje në AKPT për procedim të mëtejshëm të praktikës me aplikimin e subjektit, në rastin kur legjislacioni përcakton që natyra dhe lloji i ndërtimit janë objekt shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT);

iii) refuzim të kërkesës dhe aplikimit përkatës, duke paraqitur tek ministri informacionin me argumentet përkatëse për shkaqet e refuzimit të dhënies së lejes për punime ndërtimi.

Komisioni merr vendim me shumicë votash.

9. Për çdo kërkesë që shqyrtohet, komisioni harton procesverbalin përkatës, i cili duhet të firmoset nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.

10. Anëtarët e komisionit për çdo mbledhje do të paguhet me 10 mijë lekë, kryetari me 15 mijë lekë, ndërsa sekretari do të paguhet me 5 mijë lekë. Ky shpërblim do të sigurohet nga të ardhurat e METE-s.

11. Në rast refuzimi të kërkesës dhe aplikimit përkatës për marrje leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektësh të natyrës energjetike dhe objekte me rrezikshmëri të lartë në këtë fushë, njoftohet subjekti aplikues duke dhënë edhe argumentet përkatës për shkaqet e refuzimit të dhënies së lejes për punime ndërtimi, sipas kërkesës së paraqitur.

12. Subjekti ka të drejtë që brenda një afati 30-ditor të bëjë plotësim të mangësive të vërejtura nga komisioni për shqyrtimin e kërkesave për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektësh të natyrës energjetike dhe objekte me rrezikshmëri të lartë në këtë fushë, si dhe/ose të paraqesë materiale plotësuese dhe sqaruese për aplikimin e paraqitur.

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektësh të natyrës energjetike dhe objekte me rrezikshmëri të lartë në këtë fushë, mbi bazën e një raporti plotësues të përgatitur nga njësia e METE-s që mbulon fushën e aktivitetit energjetik përkatës për objektet për të cilat është paraqitur kërkesa dhe aplikimi përkatës për marrje leje për punime ndërtimore, brenda një periudhe 15-ditore rishqyrton aplikimin e paraqitur dhe merr vendimin përkatës.

Në rast pranimit të kërkesës dhe aplikimit të riparaqitur nga subjekti i interesuar, komisioni, në përputhje me procedurën e përshkruar në pikën 8 më sipër, paraqet për miratim tek ministri dokumentacionin përkatës.

Në rast refuzimi për herë të dytë të dhënies së lejes për punime ndërtimi, sipas kërkesës së paraqitur, subjekti ka të drejtë të paraqesë kërkesë ankimore në organet gjyqësore.

13. Njësia përkatëse që ka trajtuar aplikimin e subjektit për marrje leje për punime ndërtimore, nëpërmjet zyrës së protokollit në METE, i dorëzon përfaqësuesit ligjor të subjektit aplikues apo të autorizuarit të tij:

a) një kopje origjinale e dokumentit të lejes për punime ndërtimi të firmosur nga ministri; si dhe

b) një kopje origjinale të dokumentit të planit të vendosjes së ndërtimit, që përmban planin e vendosjes së strukturës ndërtimore, lidhjen e strukturës me infrastrukturën në zonë, si dhe pozicionin e saj në kuadër të planit të miratuar (në rast se ekzistenca e këtij plani është kërkesë e instrumentit të





planifikimit), të firmosur nga ministri dhe kryetari i njësisë së qeverisjes vendore që ka nën juridiksion zonën e vendndodhjes së strukturës që do të ndërtohet.

Zyra e protokollit në METE mban në dosjen e dokumentacionit të aplikimit dhe shqyrtimit të kërkesës së subjektit, një kopje origjinale të dokumentit të lejes për punime ndërtimi, të firmosur nga ministri, si dhe një kopje origjinale të dokumentit të planit të vendosjes së ndërtimit, që përmban planin e vendosjes së strukturës ndërtimore, lidhjen e strukturës me infrastrukturën në zonë, si dhe pozicionin e saj në kuadër të planit të miratuar (në rast se ekzistenca e këtij plani është kërkesë e instrumentit të planifikimit), të firmosur nga ministri dhe kryetari i njësisë së qeverisjes vendore që ka nën juridiksion zonën e vendndodhjes së strukturës që do të ndërtohet.

Leja/lejet për ndërtim objektesh të natyrës energjetike dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe botohet në regjistrin e planifikimit të territorit.

14. Në përfundim të punimeve të ndërtimit, të kryera në përputhje me lejen/lejet e dhëna sipas këtij udhëzimi (urdhri) për punime ndërtimi, mbi bazën e një kërkesë të paraqitur nga subjekti i pajisur me leje, e cila shoqërohet me dokumentacionin përkatës që vërteton respektimin e kushteve të lejes/lejeve, lëshohet “leja e përdorimit”.

Mbi bazën e një raporti informues që i paraqitet ministrit, i cili është përgatitur nga njësi përkatëse në METE që mbulon fushën e aktivitetit energjetik përkatës për objektet për të cilat është dhënë leja/lejet për punime ndërtimore, referuar akteve të kontrollit që vërtetojnë realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e lejes, sipas fazave të përcaktuara në rregulloret e kontrollit të zhvillimit, ministri lëshon “lejen e përdorimit” për objektin e ndërtuar.

Leja e përdorimit botohet në regjistrin e planifikimit të territorit.

Në rast refuzimi të lejes së përdorimit, në zbatim të pikës 4 të nenit 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, lëshohet akti i konstatimit të mospërputhshmërisë, i cili në pjesën e arsytimit i referohet dokumenteve të akteve të kontrollit.

15. Njësia përkatëse që ka trajtuar kërkesën e subjektit për marrje leje përdorimi, nëpërmjet zyrës së protokollit në METE, i dorëzon përfaqësuesit ligjor të subjektit aplikues apo të autorizuarit të tij një kopje origjinale të dokumentit të lejes së përdorimit të firmosur nga ministri.

Zyra e protokollit në METE mban në dosjen e dokumentacionit të subjektit aplikues, një kopje origjinale të dokumentit të lejes së përdorimit të firmosur nga ministri.

16. Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit të Buxhetit për planifikimin në buxhetin e METE-s të shpenzimeve të nevojshme për pagesën e anëtarëve të komisionit për shqyrtimin e kërkesave për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektesh të natyrës energjetike dhe objekte me rrezikshmëri të lartë në këtë fushë.

17. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen njësitë e METE, që mbulojnë aktivitetin energjetik përkatës, si dhe Drejtoria e Shërbimeve Juridike.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë, shpallet në faqen zyrtare *web* të METE-s dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS  
Nasip Naço

URDHËR  
Nr. 154, datë 13.4.2012

## PËR HAPJEN E NJËSIVE KRYESORE PRANË SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “VITRINA”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikave 5 dhe 6 të nenit 41 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 608, datë 6.5.2009 “Për licencimin e shkollës së lartë private “Vitrina”,

**URDHËROJ:**

1. Hapjen e njësive kryesore pranë shkollës së lartë private “Vitrina” në përputhje me vendimin nr. 317, datë 16.3.2012 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë “Për hapjen e njësive kryesore me emërtimet Fakulteti i Arkitekturës, Fakulteti i Mjekësisë dhe Fakulteti i Shkencave të Edukimit në shkollën e lartë private “Vitrina”, Tiranë” (bashkëlidhur këtij urdhri) si vijon:

- a) Fakulteti i Arkitekturës;
- b) Fakulteti i Mjekësisë;
- c) Fakulteti i Shkencave të Edukimit.

2. Fakulteti i Arkitekturës të ketë në përbërje këto njësi bazë:

- a) Departamenti i Arkitekturës;
- b) Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit;
- c) Departamenti i Formimit të Përgjithshëm.

3. Fakulteti i Mjekësisë të ketë në përbërje këto njësi bazë:

- a) Departamenti i Mjekësisë së Përgjithshme;
- b) Departamenti i Stomatologjisë;
- c) Departamenti i Farmacisë;
- d) Departamenti i Infermierisë.

4. Fakulteti i Shkencave të Edukimit të ketë në përbërje këto njësi bazë:

- a) Departamenti i Sociologjisë;
- b) Departamenti i Ciklit të Ulët e Parashkollor;
- c) Departamenti i Gjuhëve të Huaja.

5. Ky institucion duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë private “Vitrina”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Myqerem Tafaj**

**URDHËR**

**Nr. 187, datë 7.5.2012**

**PËR HAPJEN E FAKULTETIT TË INFERMIERISË NË UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR XHUVANI” TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës të pikave 5 dhe 6 të nenit 41 dhe pikës 1 të nenit 42 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

**URDHËROJ:**

1. Hapjen e Fakultetit të Infermierisë në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit.

2. Fakulteti i Infermierisë të ketë në përbërje këto njësi bazë:

- a) Departamenti i Infermieristikës;
- b) Departamenti i Lëndëve Klinike dhe Paraklinike;
- c) Qendra e Kërkimit dhe Zhvillimit Mjedisor e Diagnostikues;
- d) Qendra Rajonale Spitalore.

3. Fakulteti i Infermierisë të ofrojë programet ekzistuese të studimit të ciklit të parë që realizohen me 180 kredite, me kohëzgjatje normale jo më pak se 3 vite akademike, në përfundim të të cilave lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në:



- a) Infermieri e përgjithshme;  
b) Infermieri-mami.
4. Fakulteti i Infermierisë të ofrojë programin ekzistues të studimit të ciklit të dytë, që realizohet me 90 kredite me kohëzgjatje normale 1.5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master profesional”, në “Menaxhim Infermieror”.
5. Efektet financiare për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i universitetit “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit, pa efekte buxhetore shtesë.
6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti “Aleksandër Xhuvani” i Elbasanit, për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Myqerem Tafaj**

**VENDIM**  
**Nr. 27, datë 9.5.2012**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Petrit Ploçi	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Sadushi <sup>1</sup>	Anëtar i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“

me sekretare Enina Mullaj, në datën 21.6.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen nr.24/6 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Roxhers Durdaj, përfaqësuar nga avokatët Dorian Matlija dhe Andi Kananaj, me deklaram në seancë gjyqësore nga babai i të miturit.

**ALKETA HAZIZAJ,** përfaqësuar nga avokatët Dorian Matlija dhe Andi Kananaj, me deklaram në seancë gjyqësore.

Shoqata e Familjarëve të Viktimave të Shpërthimit të Gërdecit, përfaqësuar nga avokatët Dorian Matlija dhe Andi Kananaj, me prokurë të përgjithshme.

**SUBJEKT I INTERESUAR:** Fatmir Mediu, përfaqësuar nga avokatët Ardian Visha dhe Petrit Serjani, me prokurë të përgjithshme.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 5, datë 1.3.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42/2, 131/f, 134/1/g dhe 134/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 2, 6 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

<sup>1</sup> Gjyqtari S. Sadushi, i cili ka qenë relator i çështjes në seancën plenare, është larguar nga detyra në datën 23.6.2011, për shkak të mbarimit të mandatit të tij, dhe për këtë arsye nuk ka qenë pjesë e vendimmarjes së Gjykatës. Pas largimit të gjyqtarit S. Sadushi kjo çështje i është caktuar gjyqtarës A. Xhoxhaj.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Altina Xhoxhaj, përfaqësuesit e kërkuësve që kërkuan pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjektit të interesuar që kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuësit Roxhers Durdaj dhe Alketa Hazizaj, në cilësinë e personave të dëmtuar akuzues, i janë drejtuar Gjykatës së Lartë, veçmas, me kërkesë për procedim penal të shtetasit Fatmir Mediu, për kryerjen e veprës penale “plagosje e rëndë nga pakujdesia”, të parashikuar nga neni 91 i Kodit Penal (KP). Meqenëse personi ndaj të cilit është ngritur akuza gëzon cilësitë e përcaktuara në nenin 141/1 të Kushtetutës dhe nenin 75/b të Kodit të Procedurës Penale (KPP), juridiksioni fillestar për shqyrtimin e kësaj çështjeje i takon Gjykatës së Lartë.

2. Me vendimin e datës 14.12.2009, bazuar në nenin 338 të KPP-së, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i caktuar me short për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga Roxhers Durdaj, vendosi zhvillimin e seancës së pajtimit mes palëve në datën 15.1.2010. Në seancën e datës 15.1.2010, për arsye se pala e dëmtuar akuzuese kërkoi që në seancë të merrte pjesë personalisht personi i akuzuar për kryerjen e veprës penale, vendosi shtyrjen e seancës së pajtimit në datën 25.1.2010.

3. Me vendimin e datës 15.12.2009, bazuar në nenin 338 të KPP-së, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i caktuar me short për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga Alketa Hazizaj, vendosi të caktojë zhvillimin e seancës së pajtimit mes palëve në datën 25.1.2010.

4. Në seancën e datës 25.1.2010, ku u zhvillua seanca e pajtimit për të dëmtuarin akuzues Roxhers Durdaj, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë që shqyrtonte këtë kërkesë konstatoi se pranë asaj Gjykate ishte paraqitur, në të njëjtën datë dhe me të njëjtin objekt, edhe një kërkesë tjetër për procedim penal të shtetasit Fatmir Mediu, me kërkuese të dëmtuarin akuzuese Alketa Hazizaj. Në këto kushte, bazuar në nenin 92 të KPP-së, Kolegji Penal vendosi të bashkojë çështjen në gjykim, me të dëmtuar akuzues Roxhers Durdaj (nr. 4 regjistri, datë 18.11.2009) me çështjen me të dëmtuar akuzuese Alketa Hazizaj (nr. 5 regjistri, datë 18.11.2009) dhe dërgimin e akteve për t’u bashkuar me atë çështje.

5. Në seancën e datës 25.1.2010, Kolegji Penal që shqyrtonte çështjen me të dëmtuar akuzuese Alketa Hazizaj, pasi u vu në dijeni të vendimit për bashkimin e procedimeve penale, vlerësoi se nevojitej kohë për t’u njohur me dosjen dhe për kryerjen e veprimeve të nevojshme formale nga sekretaria dhe vendosi shtyrjen e seancës gjyqësore në datën 15.2.2010.

6. Në seancën e datës 15.2.2010, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë u propozoi palëve zgjidhjen e çështjes me pajtim. Duke qenë se nuk u arrit të realizohej pajtimi mes tyre dhe prej palës së dëmtuar akuzuese u kërkua vazhdimi i gjykimit të çështjes, pasi u dëgjuan përfaqësuesit e të dy palëve, u caktua seanca e radhës në datën 1.3.2010, për t’i lënë kohë palës së dëmtuar akuzuese të paraqiste dokumentet e tjera që do t’i bashkëngjiteshin kërkesës.

7. Në seancën e datës 1.3.2010, pasi administroi provat e paraqitura prej palës së dëmtuar akuzuese, përfundimisht, me vendimin nr. 5, datë 1.3.2010, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vendosi: *“mosfillimin e procedimit penal ndaj shtetasit Fatmir Mediu, për veprën penale të “plagosjes së rëndë nga pakujdesia”, të parashikuar nga neni 91 i KP-së”*.

8. Në datën 8.2.2011, kërkuësit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si jokushtetues, me pretendimin se ai ka cenuar të drejtën e tyre për një proces të rregullt, në këto drejtime:

8.1. Gjykata e Lartë nuk ka respektuar ndarjen kushtetuese mes gjyqësorit dhe prokurorisë, duke ushtruar pa të drejtë atributet e organit të akuzës. Kompetenca e mosfillimit të ndjekjes penale është aspekt i funksionit kushtetues të ushtrimit të ndjekjes penale, e cila në vetvete përfaqëson tërësinë e veprimeve procedurale të parashikuara nga ligji me qëllim vërtetimin ose rrëzimin e akuzës së ngritur. Gjykata duhet të mbetet autoritet mbi palët *“supra partes”*, ajo nuk mund të përfaqësojë akuzën, çka do të thotë se kjo e drejtë i takon vetëm të dëmtuarit akuzues.



8.2. Si rezultat i keqinterpretimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata e Lartë ka përjashtuar tërësisht pjesëmarrjen e prokurorit në gjykim, ndërkohë që në rastin e gjykimit të çështjeve me të dëmtuar akuzues ai thjesht gëzon një pozitë të veçantë, por nuk mund të përjashtohet nga gjykimi.

8.3. Gjykata e Lartë nuk mori parasysh mungesën e fazës së hetimeve paraprake. Në rastet e parashikuara në nenin 59/1 të KPP-së ka vetëm hetim gjyqësor, çka do të thotë se nuk kryhet asnjë veprim procedural që përfshihet në të gjithë Titullin VI, të Pjesës së Dytë të KPP-së, që rregullon fazën e hetimeve paraprake. Baza ligjore e përdorur nga Gjykata e Lartë përfshin nenet 290 dhe 291 të KPP-së, që bëjnë pjesë pikërisht në këtë titull. Vendimi dhe mënyra e procedimit cenoi paanshmërinë e gjykatës, pasi vendimi për mosfillimin e procedimit penal mund të merret vetëm në fazën e hetimeve paraprake.

8.4. Gjykata e Lartë u ka mohuar kërkuesve të drejtën për t'u dëgjuar, pasi ajo nuk zhvilloi hetim gjyqësor, nuk mori në shqyrtim provat, raportet mjeko-ligjore, dëshmitarët, ekspertët, dhe çështja nuk iu nënshtrua gjykimit, për arsye se nuk u respektua procedura e kërkimit të autorizimit për procedimin penal.

8.5. Gjithashtu, kërkuesve u është mohuar e drejta e ankimit në një gjykatë më të lartë. Sipas nenit 291 të KPP-së kundër vendimit për mosfillimin e ndjekjes penale lejohet ankim në gjykatë brenda 5 ditëve. Ushtrimi i dy funksioneve nga Gjykata e Lartë, atij procedues akuzues dhe atij gjyqësor, solli në vetvete një situatë të tillë që rezultoi, në praktikë, në mohimin e të drejtës së ankimit kundër këtij vendimi.

8.6. Gjykata e Lartë bëri bashkimin e çështjeve të dy kërkuesve, në shkelje të nenit 92 të KPP-së, edhe pse ato nuk ishin në të njëjtën fazë, pasi për njërën prej tyre nuk ishte kryer ende seanca e pajtimit.

8.7. Gjykata e Lartë nuk ka respektuar afatin 10 ditor për caktimin e seancës nga depozitimi i kërkesës, sipas neneve 333 dhe 338 të KPP-së.

8.8. Gjykata e Lartë e ricilësoi veprën penale, por nuk vazhdoi me gjykimin e çështjes, duke deklaruar në mënyrë të gabuar moskompetencën e saj për gjykimin e një vepre penale të ndryshme nga ajo që pretendonin kërkuesit. Gjykata e Lartë ka arsytuar në mënyrë të gabuar se akuzat për shpërdorim detyrës përjashtojnë akuzën për plagosje të rëndë nga pakujdesia dhe se veprimet e të akuzuarit, në kuadrin e shpërdorimit të detyrës, mund të kryhen vetëm me dashje dhe nuk mund të quhen të kryera nga pakujdesia.

9. **Subjekti i interesuar, Fatmir Mediu**, parashitroi para Gjykatës, në mënyrë të përmbledhur, se:

9.1. Pretendimi se nuk u respektua ndarja kushtetuese mes gjyqësorit dhe prokurorisë është i pabazuar. Po ashtu nuk qëndron edhe pretendimi se mosfillimi i një çështjeje penale përbën monopol procedural të organit të prokurorisë. Çdo vendim mosfillimi i mundshëm i prokurorit është objekt kontestimi dhe, tek e fundit, vendimmarrjeje përkatëse në gjykatën kompetente.

9.2. Në lidhje me pretendimin se nuk u mor parasysh faza e hetimeve paraprake, për vetë natyrën e këtij rasti dhe mbulimin e përditshëm mediatik, përbën një fakt të njohur botërisht jo vetëm kryerja e hetimeve paraprake, por edhe realizimi i tyre nga Prokuroria e Përgjithshme, veprimtari e cila nuk arriti në konkluzionin se veprimet apo mosveprimet e z. Mediu ishin të lidhura shkaktimisht me pasojat e rënda të ardhura nga shpërthimi në Gërdec.

9.3. Në lidhje me pretendimin për cenimin e të drejtës së ankimit, kjo është një çështje që i duhet adresuar ligjvënësit dhe jo Gjykatës Kushtetuese. I njëjti problem do të ngrihej në mënyrë hipotetike në çdo rast ku Gjykata e Lartë, për shkak të ligjit, ushtron juridiksion fillestar.

9.4. Pretendimi për bashkimin e çështjeve është i pabazuar. Nuk është e vërtetë se çështjet ishin në gjendje të ndryshme, pasi qartësisht me gjendje të njëjtë kuptojmë fazën paraprake në të cilën ky proces u mbyll ligjërisht në të dy rastet.

9.5. Të pabazuara janë edhe pretendimet e tjera të ngritura nga kërkuesit.

## II

### A. Lidhur me legjitimimin e kërkuësve

10. Gjykata vëren se, në kuptim të nenit 131, shkronja “f” të Kushtetutës ajo është kompetente për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjete juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Në lidhje me legjitimimin e kërkuësve që kanë vënë në lëvizje këtë gjykim kushtetues individual, Gjykata vlerëson se kërkuësit Roxhers Durdaj dhe Alketa Hazizaj legjitimohen *ratione personae* për paraqitjen e kërkesës, në kuptim të nenit 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës. Ata legjitimohen *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor dy vjeçar, të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata rithekson se ajo ka juridiksion vetëm për ato çështje që lidhen me pretendimet për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se pretendimet që kanë të bëjnë me shkeljen e nenit 92 të KPP-së, për arsye se janë bashkuar çështjet individuale të kërkuësve, me mosrespektimin e afatit të caktimit të datës së seancës, apo me ricilësimin e veprës penale, janë çështje që kanë të bëjnë, thelbësisht, me interpretimin e ligjit nga Gjykata e Lartë dhe kërkuësit nuk kanë arritur t’i ngrenë këto pretendime në nivel kushtetues, duke mos arritur të argumentojnë, për pasojë, se cilat elemente të procesit të rregullt ligjor kanë cenuar ato.

11. Në lidhje me kërkuësin tjetër, Shoqata e Familjarëve të Viktimave të Shpërthimit të Gërdecit, Gjykata vlerëson se ai është një subjekt që nuk ka qenë palë në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë dhe, për pasojë, duke mos provuar interesin e tij në lidhje me këtë çështje, nuk legjitimohet për t’iu drejtuar kësaj Gjykate.

### B. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të gjyimit nga një gjykatë e caktuar me ligj

12. Kërkuësit pretendojnë se Gjykata e Lartë ka ushtruar pa të drejtë atributet e organit të akuzës dhe nuk ka respektuar ndarjen kushtetuese mes gjyqësorit dhe prokurorisë, për arsye se kompetenca e mosfillimit të ndjekjes penale është aspekt i funksionit kushtetues të ushtrimit të ndjekjes penale. Sipas tyre, Gjykata e Lartë, duke marrë pa të drejtë kompetencën e përfaqësimit të akuzës, nuk qëndroi mbi palët dhe denatroyoi krejt procesin. Në rastet e parashikuara në nenin 59/1 të KPP-së ka vetëm hetim gjyqësor dhe përjashtohet faza e hetimeve paraprake.

13. Bazuar në parimin *jura novit curia*, Gjykata mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj dhe ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që i është bërë fakteve të çështjes nga kërkuësi. Në këtë kuptim Gjykata vëren se pretendimet e mësipërme të kërkuësit duhet të trajtohen në këndvështrim të respektimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, si element i të drejtës për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata ka theksuar se termi “gjykatë” karakterizohet në sensin material nga funksioni i saj gjyqësor që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë, përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 23, datë 23.7.2009; nr. 4, datë 23.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Kompetenca e gjyqtarit është kufiri që përcakton fushën e juridiksionit brenda të cilit ai është i detyruar që të procedojë për zgjidhjen e një çështjeje të caktuar. Tejkallimet e kompetencave mund të merren në shqyrtim prej Gjykatës kur ka pasur një shkelje të tillë të ligjit procedural që ka cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 11, datë 23.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Për t’i dhënë përgjigje këtij pretendimi të kërkuësit, Gjykata vlerëson të ndalet në kompetencat që Kushtetuta dhe ligji i kanë njohur organit të prokurorisë. Bazuar në nenin 148 të Kushtetutës, prokuroria ushtron ndjekjen penale si dhe përfaqëson akuzën në gjyq. Ndjekja penale (procedimi penal) përfshin dy faza të ndryshme, por të lidhura në mënyrë funksionale, fazën e hetimeve paraprake, që konsiston në kryerjen e veprimeve hetimore për të zbardhur ngjarjen dhe identifikuar



autorin, dhe fazën e gjykimit, që përfaqësohet nga mbrojtja e akuzës përpara gjykatës (*shih vendimin nr. 14, datë 21.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Në teorinë e të drejtës procedurale penale, ndjekja penale nënkupton kryerjen e të gjitha veprimeve procedurale të parashikuara nga ligji me qëllim vërtetimin e akuzës së ngritur nga prokurori. Procedimi i personit të akuzuar për kryerjen e një veprë penale nga organi i ngarkuar me këtë funksion përfshin hetimin e plotë nga organi i akuzës, mbi bazën e të cilit gjykata do të vendosë fajësinë ose pafajësinë e të dyshuarit për kryerjen e veprës penale. Procedimi penal është tagër e prokurorisë dhe i takon këtij organi, në bazë të nenit 148/1 të Kushtetutës dhe nenit 24/3 të KPP-së, të ushtrorë ndjekjen penale dhe të ngrejë akuzë publike në emër të shtetit, nëse ndodhet para kryerjes së një veprë penale të parashikuar si të tillë nga Kodi Penal (*shih vendimin nr. 3, datë 6.2.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata vëren, megjithatë, se kjo kompetencë e prokurorit nuk shtrihet mbi të gjitha veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal. Edhe pse ndjekja penale është funksion i prokurorisë, ekzistojnë disa raste, specifiku të përcaktuara, në të cilat ndjekja penale i nënshtrohet ekzistencës së një ose disa kushteve për të proceduar. Në këtë kuptim, në rastin e veprave penale për të cilat parashikohet shprehimisht ndërhyrja e të dëmtuarit akuzues, është vetëm ky person që mund të ngrejë akuzë private ndaj autorit të veprës penale. Kusht i domosdoshëm për të ngritur këtë akuzë është që i dëmtuari të jetë viktimë e njëres prej atyre veprave të parashikuara për këtë qëllim nga ligji procedural penal. Vepra të tilla konsiderohen me rrezikshmëri jo të madhe shoqërore dhe që nuk cenojnë rendin publik. Neni 59/1 KPP-së parashikon se: “Ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112 paragrafi i parë, 119, 120, 121, 122, 125, 127, 148, 149 dhe 254 të Kodit Penal ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit.” Në hartimin e kësaj dispozite, ligjvënësi është përpjekur të vendosë një balancë sa më të drejtë midis interesave publikë, nga njëra anë, të përfaqësuar dhe të mbrojtura nga prokuroria dhe interesave privatë nga ana tjetër, që lidhen ngushtë me individin dhe që për këtë arsye mund të mbrohen drejtpërdrejt prej tij.

16. Akuza private është akti me të cilin personi i dëmtuar manifeston vullnetin për të iniciuar procedimin penal dhe për të venë para përgjegjësisë autorin e një veprë penale nga e cila personit të dëmtuar, sipas vlerësimit të tij, i kanë ardhur pasoja negative. I dëmtuari akuzues mund të përcaktohet si titullar i interesit juridik të mbrojtur nga norma që pretendohet se është cenuar nga vepra penale dhe KPP-ja i njeh atij cilësinë e “subjektit të procesit”. Në këtë rast ngritja e akuzës nga i dëmtuari akuzues nuk varet nga vendimmarrja e prokurorisë, ai ka të drejtën t’i drejtohet direkt gjykatës me akuzën e tij dhe merr pjesë aktivisht në proces për ta bindur gjykatën, me anë të provave dhe fakteve, që të marrë një vendim në favor të tij, duke iu ngarkuar, njëkohësisht, edhe barra e provës për të vërtetuar para gjykatës fajësinë e personit të akuzuar. I dëmtuari akuzues ka të drejtë të shfrytëzojë të gjitha mjetet juridike të njohura nga legjislacioni procedural, përfshirë këtu edhe të drejtën e ankimit apo rekursin.

17. Në rastet kur gjykata duhet të shqyrtojë një akuzë private mbi bazën e kërkesës së të dëmtuarit akuzues, ajo është kompetente të kryejë disa veprime procedurale me qëllim dhënien e drejtësisë. Këto veprime konsistojnë në pranimin për të marrë në shqyrtim kërkesën e të dëmtuarit akuzues, vlerësimin e provave të paraqitura prej tij ose urdhërimin e organeve kompetente për të mbledhur dhe paraqitur prova, të cilat mund të jenë të rëndësishme për vërtetimin e akuzës, thirrjen e dëshmitarëve të tjerë, sipas vlerësimit të vetë gjykatës. Gjykata ka theksuar se në gjykimet mbi bazën e kërkesës së të dëmtuarit akuzues nuk ka ndjekje penale dhe as hetime paraprake, siç ndodh në rastin e akuzës publike. Në rastet e parashikuara nga neni 59/1 i KPP-së ka vetëm hetim gjyqësor, i cili shërben për të vërtetuar bazueshmërinë e kërkesës së të dëmtuarit akuzues (*shih vendimin nr. 3, datë 6.2.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata vëren se, në bazë të nenit 141/1 të Kushtetutës, “Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues. Ajo ka juridiksion fillestar kur gjykon akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese”. Po ashtu neni 75/b i KPP-së parashikon se: “Gjykata e Lartë gjykon në shkallë të parë me trup gjyqësor të përbërë nga 5 gjyqtarë të caktuar me short, veprat penale të

kryera nga Presidenti i Republikës, deputetët, Kryeministri dhe anëtarët e Këshillit të Ministrave, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë kur këta janë në këto funksione në kohën e gjykimit”. Në këto raste, duke qenë se Gjykata e Lartë ka juridiksionin fillestar, ajo zbaton dhe i nënshtrohet të njëjtave rregullave procedurale që do të zbatonte në një rast të tillë një gjykatë e zakonshme. Duke iu referuar dispozitave procedurale penale që rregullojnë gjykimin, konkretisht marrjen e vendimit, rezulton se ato janë të përfshira në Kod nën Kreun III (vendimi), Seksioni I, II dhe III. Bazuar në këto dispozita, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjykata është kompetente të vendosë: i) pushimin e çështjes (neni 387 i KPP-së) kur ndjekja penale nuk duhet të fillonte, ose nuk duhet të vazhdojë, ose kur vepra penale është shuar; ii) pafajësinë e të pandehurit (neni 388 i KPP-së) kur fakti nuk ekziston ose nuk provohet se ekziston, fakti nuk përbën vepër penale, fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, vepra penale është kryer nga një person që nuk mund të akuzohet ose të dënohet, nuk provohet që i pandehuri e ka kryer veprën që akuzohet, fakti është kryer në prani të një shkakut të përligjur ose të një shkakut padënueshmërie, si dhe kur ekziston dyshim për qenien e tyre; iii) dënimin e të pandehurit (neni 390 i KPP-së) kur i pandehuri rezulton fajtor për veprën penale që i atribuohet, duke caktuar edhe llojin dhe masën e dënimit.

19. Në kuptim të nenit 148 të Kushtetutës, procedimi penal dhe ngritja e akuzës publike është tagër e prokurorisë, kurse ngritjen e akuzës private ligjëvendësi e ka lënë në vlerësim të personit të dëmtuar nga vepra penale dhe është vetëm ky i fundit që vendos nëse do t’i drejtohet gjykatës për të provuar akuzën e tij dhe për t’u përballur me personin e akuzuar. Gjykata rithekson se, në ndryshim nga rastet tipike të akuzës publike, ku prokuroria, si organ i specializuar i ndjekjes penale, kryen hetime paraprake me qëllim të vërtetimit të akuzës dhe dërgimin e çështjes për gjykim, në rastet e akuzës private mungon faza e hetimeve paraprake që zhvillohet nga prokurori. Mungesa e fazës së hetimeve paraprake në këtë lloj gjykimi nuk nënkupton që gjykata, gjatë shqyrtimit të këtyre kërkesave, mund të ushtrojë kompetenca të cilat ligjëvendësi ia ka njohur specifikisht organit të akuzës, gjatë kësaj faze procedurale. Kompetencat e gjykatës, edhe gjatë shqyrtimit të kësaj kategorie çështjesh, janë të njëjta me ato të cilat ajo ushtron edhe në rastin kur vihet në lëvizje në bazë të akuzës së ngritur nga prokurori, qëndrim të cilin rezulton se Gjykata e Lartë e ka mbajtur në raste të tjera kur ka shqyrtuar si shkallë e parë kërkesa me të dëmtuar akuzues, për akuzë të ngritura ndaj personave me imunitet (*shih vendimet nr. 7, datë 7.6.2010; nr. 8, datë 21.6.2010; nr. 3, datë 6.6.2011 të Gjykatës së Lartë*).

20. Gjykata ka theksuar se dispozita e nenit 135 të Kushtetutës, sipas së cilës pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, në aspektin procedural penal do të thotë se një person nuk mund të deklarohet fajtor për kryerjen e një veprë penale, e as mund t’i jepet një dënim penal, pa një vendim gjyqësor, të marrë në bazë të ligjit. Në aspektin kushtetues, administrimi i drejtësisë është funksion i gjykatave, çka përcakton vendin e kësaj dege të pushtetit në sistemin e institucioneve të pushtetit shtetëror dhe statusin e gjyqtarëve. Administrimi i drejtësisë nga gjykata, që ka në themel të drejtën e personit për një arbitër të pavarur dhe të paanshëm, nënkupton shqyrtimin e një çështjeje që është përgatitur më parë dhe dhënien e një vendimi përfundimtar mbi të. Gjatë gjykimit, një gjykatë, duke ushtruar këtë funksion, është e detyruar të hetojë të gjitha rrethanat në mënyrë të plotë, në tërësi dhe në mënyrë objektive dhe ta zgjidhë çështjen në themel. Funksioni kushtetues i dhënies së drejtësisë nga gjykatat është i ndryshëm nga funksioni i ndjekjes penale që ushtron prokurori. Kur ushtron ndjekjen penale prokurori vetëm mbledh provat për të vërtetuar akuzën dhe verifikon nëse ndodhet në kushtet që e detyrojnë të pushojë akuzën ose çështjen penale, apo ta dërgojë çështjen në gjykatë. Gjykata, në përfundim të procesit, vendos për deklarimin fajtor ose të pafajshëm të të pandehurit, që do të thotë, se në ushtrim të funksionit të dhënies së drejtësisë në kontekstin penal, është gjykata që vendos për themelin e akuzës së ngritur nga prokurori (*shih vendimet nr. 14, datë 21.7.2008; nr. 10, datë 2.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Përfundimisht, Gjykata vlerëson se vendimi për mosfillimin e procedimit penal është kompetencë ekskluzive e organit të prokurorisë. Gjykata e Lartë, nëse vlerëson mungesën e kritereve ligjore për procedim, nuk mund të shprehet me vendim për mosfillimin e procedimit penal, por duhet të bazohet në dispozitat që i janë njohur asaj gjatë fazës së gjykimit. Duke marrë një vendim të tillë, për mosfillimin e procedimit penal, Gjykata e Lartë i ka atribuuar vetes një kompetencë, e cila jo vetëm që





nuk i njihet nga ligji, por që njëkohësisht i ka cenuar edhe pozicionin e saj si organ që realizon me paanshmëri dhënien e drejtësisë. Në rastet kur gjykata (e zakonshme apo dhe Gjykata e Lartë) vihet në lëvizje me anë të kërkesës së të dëmtuarit akuzues, ajo, njësoj si në rastin kur është vënë në lëvizje nga organi i prokurorisë, është e detyruar të ushtrojë funksionet e saj për dhënien e drejtësisë. Mosfillimi i ndjekjes penale është atribut vetëm i prokurorisë dhe vetëm për çështjet që, sipas KPP-së, janë në kompetencë të saj.

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, duke ushtruar kompetenca që nuk i janë njohur asaj me ligj, ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, si element i të drejtës për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës.

22. Gjykata vëren, gjithashtu, se bazuar në nenin 59/2 të KPP-së, në rastin e gjykimit të kërkesave me të dëmtuar akuzues, prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësisë së tij. Në këtë kategori çështjesh pozita procedurale e prokurorit është e një lloji të veçantë. Ai nuk është palë në debatin gjyqësor që zhvillohet midis të pandehurit dhe të dëmtuarit akuzues, por është i përjashtuar nga roli i tij si përfaqësues i akuzës dhe si autoritet që ushtron ndjekjen penale. Gjykata ka theksuar se si akuza publike, ashtu edhe akuza private, të parashikuara nga legjislati procedural penal, janë dy mekanizma që shërbejnë për ndjekjen penale të autorit të veprës penale dhe në asnjë rast ato nuk kanë për qëllim eliminimin e njëra tjetrës. Ato bashkëveprojnë dhe në raste të caktuara gjejnë zbatim veçmas. Akuza publike nuk mund të shmanget. Ajo ushtrohet sa herë që prokuroria krijon bindjen se vepra e kryer cenon rendin publik apo interesin e shoqërisë. Këtë prokuroria e bën duke ndërhyrë në procesin e iniciuar nga i dëmtuari akuzues (*shih vendimin nr. 3, datë 6.2.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata konstaton se gjykimi i çështjes konkrete në shqyrtim është bërë në mungesë të përfaqësuesit të organit të akuzës. Nga dosja gjyqësore nuk rezulton që ai të jetë njoftuar nga Gjykata e Lartë për gjykimin, në mënyrë që t'i krijohej mundësia për të qenë i pranishëm në seancat gjyqësore të zhvilluara në atë gjykatë. Neni 128, pika 1, shkronja “b” i KPP-së parashikon se aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me të drejtën e prokurorit për pjesëmarrjen e tij në gjykim. Në këtë kuptim, mungesa e prokurorit në gjykim, në procesin e vënë në lëvizje nga i dëmtuari akuzues, passjell pavlefshmërinë absolute të procesit, pa e lënë këtë pjesëmarrje në vlerësimin e këtij të fundit ose gjykatës.

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se procesi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë është i cenueshëm edhe për shkak të zhvillimit të tij në mungesë të përfaqësuesit të organit të akuzës, gjë që e bën atë të parregullt në kuptim kushtetues.

#### *C. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar*

24. Kërkesit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë u ka mohuar të drejtën për t'u dëgjuar, pasi ajo ka arritur në konkluzionin se nuk ekzistojnë elementet e veprës penale pa bërë hetim gjyqësor dhe pa ia nënshtruar provat e paraqitura debatit gjyqësor.

25. Në lidhje me këtë pretendim Gjykata, gjatë votimit të çështjes, nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj<sup>1</sup>, të kërkuar nga neni 133/2 i Kushtetutës dhe neni 72/1 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Në këto kushte, në bazë të nenit 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, ky pretendim i kërkesit refuzohet.

#### *Ç. Lidhur me pretendimin për cenimin e të drejtës së ankimit*

26. Kërkesit kanë pretenduar, gjithashtu, se u është mohuar e drejta e ankimit në një gjykatë më të lartë. Sipas tyre, Gjykata e Lartë nuk e ka marrë parasysh ankimin e paraqitur ndaj vendimit nr. 5, datë 1.3.2010, me arsyetimin se vendimet e saj janë të paankimueshme.

27. Në nenin 43 të Kushtetutës parashikohet se çdokush ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. E drejta e ankimit kundër një vendimi gjyqësor, mbi bazën e parashikimit kushtetues, është rregulluar edhe nga

<sup>1</sup> Votuan për pranimin: B. Dedja; V. Kristo; P. Plloçi; S. Berberi. Votuan për rrëzimin: V. Tusha; A. Thanza; A. Xhoxhaj

dispozitat materiale e procedurale konkrete. Kjo e drejtë duhet kuptuar si mundësi e çdo individit për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj. Kushtetuta i garanton individit të drejtën për t'u ankuar të paktën një herë ndaj një vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që e drejta e ankimit nuk mund të jetë subjekt i kufizimeve. Kreu i të drejtave themelore, i parashikuar në Kushtetutë, ka një përmbajtje të tillë që, si rregull, nuk përjashton ndonjë të drejtë nga kufizimi dhe, në këtë kuptim, vlera e nenit 43 të Kushtetutës nuk mund të qëndrojë e ndarë nga vlerat e tjera kushtetuese siç është dhe ajo e rasteve përjashtimore për kufizimin e një të drejte themelore (*shih vendimin nr. 12, datë 14.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjykata vëren se, në bazë të nenit 2 të Protokollit 7 të KEDNJ-së, çdo person i deklaruar fajtor për një vepër penale nga një gjykatë ka të drejtë të paraqesë për shqyrtim përpara një gjykate më të lartë deklarimin e fajësisë ose dënimit. Nga kjo e drejtë mund të ketë përjashtime në rastin kur ndodhemi përpara rasteve të gjykimit në shkallë të parë nga gjykata më e lartë. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar se “shtetet kontraktuese gëzojnë, në parim, një hapësirë vlerësimi në përcaktimin se si e drejta e ankimit, e parashikuar në nenin 2 të Protokollit 7 të KEDNJ-së, duhet të ushtrohet” (*shih Krombach kundër Francës, vendimi datë 13 shkurt 2001, §96*). Duke u nisur nga përmbajtja e nenit 2 të Protokollit 7 të KEDNJ-së, pranohet se, për vendime të dhëna në shkallë të parë nga gjykata më e lartë, siç është rasti konkret i juridiksionit fillestar të Gjykatës së Lartë, për gjykimin e funksionarëve të lartë të shtetit, këto vendime janë të paankimueshme. Gjykata rithekson se, bazuar në nenin 135 të Kushtetutës, pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe ato të shkallës së parë, një organizim në të cilin Gjykata e Lartë përfaqëson organin më të lartë të sistemit gjyqësor. Bazuar në nenin 141 të Kushtetutës, Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues, ku në nocionin kushtetues të rishikimit futet, në radhë të parë, shqyrtimi i rekruseve për pretendimet e shkeljes të ligjit material ose procedural, çka përbën funksionin kryesor të Gjykatës së Lartë. Si përjashtim, bazuar po në nenin 141/1 të Kushtetutës dhe nenin 75/b të KPP-së, Gjykata e Lartë ka edhe juridiksion fillestar në rastin kur gjykon akuzat penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë, vendime për të cilat, duke qenë se shqyrtohen, edhe pse si gjykatë e zakonshme, nga organi më i lartë i piramidës gjyqësore nuk mund të parashikohet ankim në një gjykatë të lartë, por ato mund të ankimohen vetëm në Gjykatën Kushtetuese dhe vetëm për pretendime që lidhen me cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Fakti që në rastin e shqyrtimit të këtyre çështjeve nga Gjykata e Lartë, si gjykatë e shkallës së parë, nuk është parashikuar e drejta e ankimit në një gjykatë më të lartë, nuk e bën procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese.

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës të paraqitur nga kërkuesit Roxhers Durdaj dhe Alketa Hazizaj.
- Rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuesi Shoqata e Familjarëve të Viktimave të Shpërthimit të Gërdecit, për mungesë legjitimitimi.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 5, datë 1.3.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Pllaçi, Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza.

Anëtarë kundër: Vitore Tusha



## MENDIM PARALEL

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka pranuar pretendimet e kërkuarve Roxhers Durdaj dhe Alketa Hazizaj (ndërkohë që subjekti tjetër kërkuar, Shoqata e Familjarëve të Viktimave të Shpërthimit të Gërdecit, nuk është legjitimuar për t'iu drejtuar kësaj Gjykate), duke shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën vendimin nr. 5, datë 1.3.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me arsyetimin se Gjykata e Lartë, duke vendosur mosfillimin e procedimit penal, i ka atribuar vetes një kompetencë që ligji i njej organit të prokurorisë (*shih paragrafin 21 të vendimit*). Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj.

2. Pavarësisht se në qëndrimin përfundimtar pajtohem me vendimin e shumicës për pranimin e kërkesës, kam mendim të kundërt lidhur me standardin kushtetues për të cilin ajo (shumica) pretendon se është cenuar.

3. Sikurse edhe shumica, mendoj se vendimi për mosfillimin e ndjekjes penale është atribut vetëm i organit të prokurorisë dhe vetëm për çështjet që, sipas KPP-së, janë në kompetencë të saj e, për pasojë, Gjykata e Lartë duke marrë një vendim të tillë ka ushtruar kompetenca që nuk i janë njohur asaj me ligj, por nuk mendoj se në këtë mënyrë kërkuarve i është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj.

4. Në jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës, gjykimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj, sipas nenit 42/2 të Kushtetutës, është një element i procesit të rregullt ligjor. Gjykata është shprehur se fraza “gjykatë e caktuar me ligj” mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës, por edhe kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete (*shih vendimet nr. 14, datë 17.4.2007; nr. 11, datë 23.4.2009; nr. 11, datë 23.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë prej ligjit.

5. Një gjykatë karakterizohet, në kuptimin thelbësor të shprehjes, nga funksioni i saj gjyqësor, me të cilin duhet kuptuar të vendosurit mbi çështjet brenda kompetencave të saj, bazuar në rregullimet ligjore dhe sipas procedurave të zhvilluara në mënyrë të përcaktuar. Ajo duhet gjithashtu të kënaqë një numër kërkesash të mëtejshme si pavarësia, veçanërisht prej ekzekutivit, paanësia, qëndrueshmëria në detyrë e anëtarëve të saj dhe garancitë e ofruara nga procedura e saj (*shih vendimin nr. 31, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Kompetenca e gjyqtarit është kufiri i fundit që përcakton fushën e juridiksionit brenda të cilit ai është i detyruar që të procedojë për zgjidhjen e një çështjeje të caktuar. Tejkallimet e kompetencave mund të merren në shqyrtim prej Gjykatës kur ka pasur një shkelje të tillë të ligjit procedural që ka cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Detyrimi i respektimit nga gjyqtari të kufirit të kompetencës është, ndër të tjera, parakusht për të mos lejuar që shumë gjyqtarë të ushtrojnë të njëjtin pushtet me vendime për një fakt të caktuar. Prandaj, për çdo rast dhe çështje të mundshme, ligji ka parashikuar një gjykatë kompetente për të gjykuar. Marrja nga një gjykatë e kompetencës që i takon me ligj një gjykate tjetër, mund të bëhet vetëm nëse e lejon ligji dhe vetëm nga gjykatat që ai cakton (*shih vendimin nr. 11, datë 23.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Duke shkuar më tej, rastet konkrete të marra në shqyrtim nga kjo Gjykatë për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, kanë të bëjnë me kompozimin e trupit gjykues (gjyqtar i vetëm apo një trup gjykues) lidhur me vlerën e kërkesëpadisë (*shih vendimet nr. 35, datë 12.12.2003 dhe nr. 13, datë 18.5.2006 të Gjykatës Kushtetuese*); me kompetencën lëndore të Gjykatës për Krime të Rënda për gjykimin e disa veprave të caktuara penale, të cilat, për shkak të ndryshimeve në KPP, i përkasin kompetencës së gjykatave të zakonshme, në kushtet kur ligji i ri nuk përmban asnjë dispozitë transitorë për mënyrën se si do të veprohej për çështjet e regjistruara në gjykatat e krimeve të rënda (*shih vendimin nr. 11, datë 23.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*); me respektimin e procedurës së shortit në caktimin e gjyqtarit kompetent për të shqyrtuar çështjen (*shih vendimin nr. 31, datë 5.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Nga analiza e këtyre rasteve mendoj se parimi i gjykatës së caktuar me ligj sanksionon përbërjen e trupit gjykues, kompetencën (lëndore, tokësore, etj.) apo juridiksionin e gjykatës në gjykimin e çështjes; ndërsa, në rastin kur është pretenduar cenimi i këtij parimi për shkak të mënyrës së përfundimit të gjykimit (në rastin konkret kërkuesi ka pretenduar se çështja nuk është gjykuar nga një “gjykatë e caktuar me ligj” pasi Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk kanë dalë me vendim unifikues), Gjykata, në vendimin nr. 18, datë 3.5.2007, duke vlerësuar se “*në përfundim të shqyrtimit të çështjes, si kolegji civil ashtu dhe kolegjet e bashkuara, kanë të njëjtat mundësi procedurale për të vendosur*” ka çmuar se shqyrtimi i çështjes nga Kolegjet e Bashkuara (edhe pse ato nuk kanë përfunduar gjykimin me vendim unifikues) nuk e keqëson mundësinë procedurale të kërkuesit dhe, për pasojë, ka theksuar se nuk është cenuar parimi *de quo*.

9. Nisur nga kjo premisë, në rastin objekt shqyrtimi, sikurse është shprehur dhe shumica, Gjykata e Lartë, bazuar në nenin 141/1 të Kushtetutës dhe 75/b të KPP-së, ka juridiksion fillestar, pra gjykon në shkallë të parë, ndër të tjera, për akuzat penale në ngarkim të anëtarëve të Këshillit të Ministrave. Në këtë kuptim, mendoj se ajo është gjykata e caktuar me ligj që ka juridiksionin dhe kompetencën për të dëgjuar dhe shqyrtuar çështjen.

10. Fakti se Gjykata e Lartë, në momentin e marrjes së vendimit, nuk ka vendosur në një nga mënyrat e parashikuara nga KKP-ja, pra nuk ka vendosur pushimin e çështjes sipas nenit 387 të KPP-së, pafajësinë e të pandehurit sipas nenit 388 të KPP-së apo dënimin e tij sipas nenit 390 të KPP-së, nuk do të thotë që ajo (Gjykata e Lartë) nuk është gjykata kompetente me ligj për të shqyrtuar çështjen. Përkundrazi, mendoj se Gjykata e Lartë, sipas nenit 141/1 të Kushtetutës dhe 75/b të KPP-së, është i vetmi organ që ka juridiksion për shqyrtimin e çështjes *de quo* dhe se ajo ka vendosur mbi një çështje që hyn në kompetencat e saj, por duke bërë një interpretim të gabuar të dispozitave që sanksionojnë mënyrën e përfundimit të gjykimit (marrjen e vendimit).

11. Për sa më lart, mendoj se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mosfillimin e procedimit penal, nuk i ka mundësuar kërkuesve të kenë një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pra të realizojnë efektivisht të drejtën e aksesit në gjykatë, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

12. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, e drejta për akses në gjykatë të referon tek e drejta që ka çdo individ për t’u drejtuar në një gjykatë që ka juridiksion të plotë për të zgjidhur çështjen. Kjo e drejtë nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në një shoqëri demokratike, e drejta për administrim të mirë të drejtësisë zë një vend të dallueshëm dhe asnjë interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e tyre. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 10, datë 29.3.2011; nr. 26, datë 13.6.2011; nr. 41, datë 28.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjithashtu, e drejta për t’u drejtuar gjykatës, e parë nga këndvështrimi i nenit 42 të Kushtetutës, ka për qëllim t’u garantojë palëve në proces të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’i vendosur ato në çdo rast në pozita të barabarta para gjykatës. Në këtë këndvështrim, Gjykata ka vlerësuar se normat dhe parimet kushtetuese, ku bën pjesë edhe e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, përbëjnë bazën e nocionit të dhënies së drejtësisë. Administrimi i drejtësisë nga gjykata, që ka në themel të drejtën e personit për të pasur një arbitër të pavarur dhe të paanshëm, nënkupton shqyrtimin e një çështjeje që është përgatitur më parë dhe dhënien e një vendimi përfundimtar mbi të. Gjatë shqyrtimit, gjykata, në ushtrimin e funksioneve të saj, është e detyruar të hetojë të gjitha rrethanat në mënyrë të plotë, në tërësi dhe në mënyrë objektive dhe ta zgjidhë çështjen në themel (*shih vendimin nr. 10, datë 2.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin objekt shqyrtimi, mendoj se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mosfillimin e procedimit penal, nuk ka shqyrtuar dhe zgjidhur çështjen në themel, duke cenuar të drejtën e kërkuesve për të pasur një zgjidhje përfundimtare të mosmarrëveshjes në një nga mënyrat e parashikuara në nenet 387, 388 dhe 390 të KPP-së, që bëjnë fjalë për mënyrën e përfundimit të



shqyrtimit gjyqësor. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e kërkuesve për t'iu drejtuar gjykatës e si pasojë edhe të drejtën e palëve për t'u dëgjuar. Në këtë këndvështrim, jam i mendimit se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar kërkuesit të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Anëtar: Vladimir Kristo

#### MENDIM PAKICE

Në lidhje me cenimin e standardit të gjykatës së caktuar me ligj, ndaj qëndrim të ndryshëm nga shumica dhe, për këtë arsye, parashtroj mendimin tim në pakicë.

Në vendimin e saj, shumica ka vlerësuar se Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës, duke arsyetuar se vendimi për mosfillimin e procedimit penal është kompetencë ekskluzive e organit të prokurorisë dhe se Gjykata e Lartë, nëse vlerëson mungesën e kriterëve ligjore për procedim, nuk mund të shprehet me vendim për mosfillimin e procedimit penal, por duhet të bazohet në dispozitat që i janë njohur asaj gjatë fazës së gjykimit.

Gjykimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj është një element i procesit të rregullt ligjor, dhe fraza "gjykatë e caktuar me ligj" e përcaktuar në nenin 42/2 të Kushtetutës mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës, por edhe kompozimin e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështje konkrete (*shih vendimet nr. 14, datë 17.4.2007; nr. 11, datë 23.4.2009; nr. 11, datë 23.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Verifikimi i kompetencës, i juridiksionit, apo përbërjes së rregullt të trupit gjykues për gjykimin e një çështjeje, si momente thelbësore të një procesi ligjor, të cilat kanë gjetur pasqyrim në pjesë të veçanta të Kodeve të Procedurës, mbeten si një detyrim për t'u zgjidhur nga vetë gjykata dhe që nuk lidhen domosdoshmërisht me disponibilitetin e palëve në gjykim. Gjykata ka theksuar se termi gjykatë karakterizohet në sensin material nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 22, 22.7.2009; nr. 23, datë 23.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

Bazuar në nenin 141/1 të Kushtetutës, Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues. Ajo ka juridiksion fillestar kur gjykon akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Po ashtu, në nenin 75/b të KPP-së parashikohet se Gjykata e Lartë gjykon në shkallë të parë veprat penale të kryera nga Presidenti i Republikës, deputetët, Kryeministri dhe anëtarët e Këshillit të Ministrave, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, kur këta janë në këto funksione në kohën e gjykimit.

Për sa më sipër, rezulton se Gjykata e Lartë ka qenë gjykata kompetente për të shqyrtuar këtë çështje dhe, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, ajo ka qenë gjykata e caktuar me ligj. Në lidhje me veprimet konkrete dhe vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, rezulton se në të gjitha rastet kur Gjykata e Lartë ushtron juridiksionin e saj fillestar, ajo zbaton dhe i nënshtrohet të njëjtave rregullave procedurale që zbaton një gjykatë e zakonshme fakti. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se në rastet kur gjykata duhet të shqyrtojë një akuzë private mbi bazën e kërkesës së të dëmtuarit akuzues, ajo është kompetente të kryejë disa veprime procedurale me qëllim dhënien e drejtësisë. Këto veprime konsistojnë në pranimin për të marrë në shqyrtim kërkesën e të dëmtuarit akuzues, vlerësimin e provave të paraqitura nga i dëmtuari ose urdhërimin e organeve kompetente për të mbledhur dhe paraqitur prova, të cilat mund të jenë të rëndësishme për vërtetimin e akuzës, thirrjen e dëshmitarëve të tjerë sipas vlerësimit të vetë gjykatës. Në rastet e parashikuara nga neni 59/1 i KPP-së ka vetëm hetim gjyqësor, i cili shërben për të vërtetuar bazueshmërinë e kërkesës së të dëmtuarit dhe jo të akuzës publike të ngritur nga organi i prokurorisë. Të dëmtuarit i krijohet mundësia që edhe pa pjesëmarrjen e prokurorit të arrijë të përballet para gjykatës me autorin e veprës penale nga e cila atij i ka ardhur dëmi (*shih vendimin nr. 3, datë*

6.2.2008 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata e zakonshme është i vetmi organ procedues për veprat penale që ndiqen mbi kërkesën e të dëmtuarit akuzues (*shih vendimin nr. 39, datë 23.6.2000 të Gjykatës Kushtetuese*).

Bazuar në nenin 359 të KPP-së, hetimi gjyqësor bëhet në seancë dhe fillon me marrjen e provave të kërkuara nga i dëmtuari akuzues, prova të cilat shqyrtohen nga gjykata në funksion të dhënies së vendimit. Nëse Gjykata e Lartë (e cila në këto raste zbaton dispozitat që rregullojnë gjykimin në shkallë të parë), mbi bazën e provave të shqyrtuara, konstaton ekzistencën e rrethanave që nuk lejojnë fillimin e procedimit, bazuar në nenin 387 të KPP-së ajo merr vendim për pushimin e çështjes.

Nga arsyetimi i vendimit të shumicës rezulton se shkak për shfuqizimin dhe cenimin e të gjithë procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë është vetëm përmbytja e dispozitivit të vendimit nr. 5, datë 1.3.2010 të Kolegjit Penal të asaj gjykate. Edhe pse jam dakord me vendimin e shumicës se vendimi për mosfillimin e procedimit penal është përcaktuar nga KPP-ja si vendim që mund të merret nga organi i prokurorisë, në rastin në shqyrtim vlerësoj se nuk ka dallim esencial për sa i përket pasojave juridike që sjell për kërkuesin vendimi për pushimin (i parashikuar si vendim që mund të merret nga gjykata, në mbështetje të nenit 387 të KPP-së), dhe ai për mosfillimin e çështjes penale (i parashikuar si vendim që mund të merret nga prokurori, në mbështetje të nenit 291/1 të KPP-së).

Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se sipas nenit 42/2 të Kushtetutës, kushdo mund t'i drejtohet gjykatës për të mbrojtur një të drejtë, liri apo interes kushtetues e ligjor. E drejta për akses në gjykatë të referon tek e drejta që ka çdo individ për t'u drejtuar me padi në një gjykatë që ka juridiksion të plotë për të zgjidhur çështjen. Dispozita i garanton subjekteve të cenuar të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë, publik e të paanshëm. Neni 42 i Kushtetutës i siguron çdokujt të drejtën për të pretenduar të drejtat para një gjykate ose tribunali. Në këtë kuptim, ky standard përfshin të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të filluar një proces, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit në një organ gjyqësor duhet të jetë një e drejtë që lidhet me themelin dhe jo një e drejtë e pastër formale. E drejta për t'u drejtuar gjykatave nuk përfshin vetëm të drejtën për të hapur një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare në lidhje me mosmarrëveshjen.

Bazuar në dosjen gjyqësore, rezulton se kërkuesit, në cilësinë e personave të dëmtuar akuzues, i janë drejtuar Gjykatës së Lartë, veçmas, me kërkesë për procedim penal të shtetasit F.M., për kryerjen e veprës penale "plagosje e rëndë nga pakujdesia", të parashikuar nga neni 91 i Kodit Penal (KP) dhe më pas këto dy kërkesa janë bashkuar për tu gjykuar në një çështje të vetme. Gjykata e Lartë ka proceduar duke zhvilluar fillimisht seancën e pajtimit mes palëve dhe në kushtet kur nuk u arrit ky pajtim ka vazhduar me gjykimin e çështjes penale. Pasi ka dëgjuar përfaqësuesit e të dy palëve (seanca e datës 15.2.2010) Gjykata e Lartë ka caktuar seancën e radhës në datën 1.3.2010, për t'i lënë kohë palës së dëmtuar akuzuese të paraqiste provat që do t'i bashkëngjiteshin kërkesës. Në seancën e datës 1.3.2010, pasi ka administruar provat e paraqitura prej palës së dëmtuar akuzuese, përfundimisht, me vendimin nr. 5, datë 1.3.2010, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur: "*mosfillimin e procedimit penal ndaj shtetasit Fatmir Mediu, për veprën penale të "plagosjes së rëndë nga pakujdesia", të parashikuar nga neni 91 i KP-së*".

Duke pasur parasysh fazat që ndjek ky lloj gjykimi, ku përfshihet paraqitja e kërkesës pranë Gjykatës së Lartë, seanca e pajtimit mes palëve, dhe më pas zhvillimi i hetimit gjyqësor, mendoj se pas paraqitjes së kërkesës dhe deri në përfundimin e hetimit gjyqësor dhe dhënien e një vendimi nga gjykata, të dëmtuarve akuzues u është njohur e drejta të paraqisnin prova para gjykatës për të vërtetuar akuzat e ngritura prej tyre. Nga ana tjetër vendimi i marrë nga Gjykata e Lartë, për shkak të pasojave që ka sjellë, nuk u ka cenuar kërkuesve të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Për të gjitha arsyet e parashtruara më sipër, vlerësoj se në thelb, procesi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë nuk paraqet probleme kushtetutshmërie të tilla që të sillnin shfuqizimin e vendimit të dhënë nga ajo gjykatë dhe se kërkesa duhej të ishte rrëzuar si e pabazuar.

Anëtare: Vitore Tusha



**VENDIM**  
**Nr. 39 datë 23.4.2012**

**PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT PËR MENAXHIMIN DHE ALOKIMIN E KAPACITETEVE NË PROJEKTIN “TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP)”, SIPAS PARAGRAFIT 6 TË NENIT 36 TË DIREKTIVËS 2009/73/EC**

Në mbështetje nenit 40 të ligjit nr. 9946, date 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror” dhe neni 25 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 17.10.2011 të Bordit të Komisionerëve, dhe vendimin nr. 155, datë 19.12.2011, për fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin nga aksesi i palëve të treta të paraqitur nga ana e kompanisë TAP AG, duke marrë parasysh gjithashtu që:

- Direktiva 2009/73/EC është e zbatueshme për Italinë dhe Greqinë, si shtete anëtare të Bashkimit Europian dhe është transpozuar në legjislacionin përkatës kombëtar të këtyre vendeve; dhe

- Direktiva 2003/55/EC është e zbatueshme për Shqipërinë si palë kontraktuese e Komunitetit të Energjisë dhe është transpozuar në legjislacionin kombëtar;

- Këshilli i Ministrave të Komunitetit të Energjisë ka vendosur më 6 tetor, 2011, që direktiva 2009/73/EC dhe rregullorja 715/2009, do të duhet të zbatohen nga të gjitha palët kontraktuese brenda vitit 2015;

- Neni 22 i direktivës 2003/55/EC, neni 36 i direktivës 2009/73/EC dhe legjislacioni kombëtar, kërkojnë që në rastin kur infrastruktura në fjalë shtrihet në territorin e me shumë së një vendi, çdo vendim për përjashtim prej të drejtës së aksesit të palëve të treta, (TPA) duhet të merren në bashkëpunim mes autoriteteve kombëtare të vendeve përkatëse.

Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.4.2012, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, në lidhje me draft udhëzuesin që ka rezultuar prej bashkëpunimit të tre rregullatorëve,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e udhëzuesit për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve në projektin “Trans Adriatik Pipeline (TAP)”, sipas paragrafit 6 të nenit 36 të direktivës 2009/73/EC.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**UDHËZUES**

**PËR MENAXHIMIN DHE ALOKIMIN E KAPACITETEVE NË PROJEKTIN TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP), SIPAS PARAGRAFIT 6 TË NENIT 36 TË DIREKTIVËS 2009/73/EC**

**FAZA I: FTESA E PALËVE TË INTERESUARA PËR SHPREHJEN E INTERESIT TË TYRE PËR REZERVIM KAPACITETI**

Duke pasur parasysh se:

a) Kompania TAP-AG i ka paraqitur Autoriteteve Kombëtare të Shqipërisë (më tej referuar ERE), Greqisë (më tej referuar RAE) dhe Ministrisë Italiane (Ministro dello Sviluppo Economico/Ministria e Zhvillimit Ekonomik) aplikimin e saj për përjashtimin prej të drejtës së aksesit të palëve të

treta (TPA) për projektin e gazsjellësit Trans Adriatik Pipeline (më tej referuar projekti TAP), që shtrihet përgjatë tre vendeve dhe kualifikohet si linjë interkoneksioni;

b) Ministria Italiane ka ftuar Autoritetin Kombëtar Italian (më tej referuar AEEG) të përcaktojë së bashku me RAE dhe ERE procedurat e testimit të tregut për tubacionin e gazit TAP;

c) Direktiva 2009/73/EC është e zbatueshme për Italinë dhe Greqinë, si shtete anëtare të Bashkimit Europian dhe është transpozuar në legjislacionin përkatës kombëtar të këtyre vendeve;

d) Direktiva 2003/55/EC është e zbatueshme për Shqipërinë si palë kontraktuese e Komunitetit të Energjisë dhe është transpozuar në legjislacionin kombëtar;

e) Neni 22 i direktivës 2003/55/EC, neni 36 i direktivës 2009/73/EC dhe legjislacioni kombëtar, kërkojnë që në rastin kur infrastruktura në fjalë shtrihet në territorin e me shume së një vendi, çdo vendim për përjashtim prej të drejtës së aksesit të palëve të treta, (TPA) duhet të merren në bashkëpunim mes autoriteteve kombëtare të vendeve përkatëse;

f) Këshilli i Ministrave të Komunitetit të Energjisë ka vendosur më 6 tetor, 2011, që direktiva 2009/73/EC dhe rregullorja 715/2009, do të duhet të zbatohen nga të gjitha palët kontraktuese brenda vitit 2015.

Autoritetet rregullatore kombëtare të Shqipërisë, Greqisë dhe Italisë kanë përgatitur bashkërisht këto udhëzime për menaxhimin dhe alokimin e kapacitetit të projektit TAP, sipas paragrafit 6 të nenit 36, të direktivës 2009/73/EC, faza e parë e të cilës ka të bëjë me ftesën e palëve të interesuara për të shprehur interesin për të rezervuar kapacitet në projektin e sipërcituar.

Autoritetet rregullatore kombëtare të Shqipërisë, Greqisë dhe Italisë kanë vendosur bashkërisht si më poshtë:

#### Neni 1 Përkufizimet

1.1 Përkufizimet e vlefshme janë si vijon:

a) Autoritetet: Autoritetet kombëtare rregullatore (NRA) të Shqipërisë (Enti Rregullator i Energjisë - ERE), Greqisë (Autoriteti Rregullator për Energjinë/Regulatory Authority for Energy - RAE) dhe Italisë (Autoriteti për Energjinë Elektrike dhe Gazin/ Autorità per l'Energia Elettrica e il Gas - AEEG);

b) Ditë(t): ditë(t) kalendarike;

c) Direktiva: direktiva 2009/73/EC;

d) Aplikimi për përjashtim: aplikimi për përjashtim i dërguar nga kompania TAP AG, autoriteteve; (ref: Autorità per l'energia elettrica e il Gas datë 29/8/2011, 22.591, Entit Rregullator të Energjisë (ERE), prot. nr. 278, datë 29/8/2011, RAE Ref. I-143197/31.8.2011);

e) Kapaciteti shtesë: shtesa e kapacitetit fillestar 10 miliard metra kub normal/vit;

f) Vendet pritëse: Shqipëria, Greqia dhe Italia;

g) Testi i tregut: Procesi i përcaktuar në paragrafin 6 të nenit 36 të direktivës për të vlerësuar interesin e të gjithë përdoruesve të mundshëm për të kontraktuar kapacitet përpara se të kryhet alokimi i kapaciteteve në infrastrukturën e re;

h) Gaz objekt sanksionesh: gazi natyror, i cili:

a) Është nxjerrë prej depozitave hidrokarbure të një juridiksioni objekt sanksionesh (gaz objekt kufizimesh)

b) Është bërë i disponueshëm për treguesin e këtij gazi si rezultat direkt ose indirekt ose si pasojë e ndonjë kontrate ose ujdje tjetër, pjesë e së cilës tregtuesi ose ndonjë filial i tij, ose persona të lidhur (Offtaker/marrësi) janë palë, nëpërmjet të cilës marrësi blen gazin objekt kufizimesh ose është bërë i disponueshëm për treguesin si pasojë direkte ose indirekte e ndonjë ujdje tjetër, e cila ka pasojë të ngjashme ekonomike dhe praktike.

Për qëllime të këtij përkufizimi, juridiksion objekt sanksionesh do të thotë çdo juridiksion në lidhje me të cilin çdo aktivitet tregtar, importi ose eksporti me këtë juridiksion ose personat që banojnë në këtë juridiksion dhe në përputhje me sanksionet e imponuara nga ndonjëri prej BE, OKB ose SHBA





për çdo rast që ka lidhje me aktivitete terroriste ose sponsorizime ose përfitimin ose posedimin e armëve të dëmtimit në masë (Weapon of Mass Destruction - WMD).

i) TAP AG: Kompania Trans Adriatik Pipeline AG, me zyrë të regjistruar në Baar, Zvicër, Lindenstrasse 2.

## Neni 2

### Objekti dhe qëllimi

2.1 Në përputhje me nenin 36.6 të direktivës, pas “Aplikimit për përjashtim” të dorëzuar nga TAP AG për projektin “Trans Adriatik Pipeline”, para se të vendoset mbi përjashtimin nga e drejta e aksesit të palëve të treta, autoritetet duhet të vendosin mbi rregullat dhe mekanizmat për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve. Këto rregulla kërkojnë që të kryhet paraprakisht një test i tregut.

2.2 Për projektin e sipërpërmendur TAP, testi i tregut është i strukturuar në dy faza:

1. Faza e shprehjes së interesit;

2. Faza e rezervimit.

2.3 Në fazën e shprehjes së interesit të gjithë përdoruesit e mundshëm, institucionet dhe TSO-të janë të ftuar të shprehin interesin e tyre, sipas këtyre udhëzimeve, për kontraktimin e kapaciteteve ose për t'u lidhur me infrastrukturën dhe iu kërkohet që të paraqesin të dhëna dhe informacione, në mënyrë që autoritetet të vlerësojnë përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në nenin 36.1 të direktivës. Faza e Shprehjes së interesit nuk i detyron as pjesëmarrësit të rezervojnë kapacitetin për të cilin ata kanë shprehur interes dhe as TAP AG që ta japë atë. Megjithatë pjesëmarrja në fazën e shprehjes së interesit është një parakusht për të marrë pjesë në fazën e rezervimit.

2.4 Në fazën e rezervimit, përdoruesve potencialë do t'u kërkohet të ofertojnë dhe të regjistrohen për kapacitetet e gazsjellësit Trans Adriatik Pipeline. Si rezultat i fazës së rezervimit, alokimi i kapacitetit me terma afatgjatë do të kryhet sipas kontratave “transporto ose paguaj”, në varësi të vendimit përfundimtar për kryerjen e investimit nga ana e TAP AG dhe aksionarëve të tij që do të çojë në realizimin faktik të infrastrukturës.

2.5 Ky dokument jep kuadrin e përgjithshëm të procedurave të alokimit dhe menaxhimit të kapaciteteve, dhe përcakton në mënyrë të veçantë, si të kryhet faza e shprehjes së interesit.

## Neni 3

### Kuadri i rregullave dhe mekanizmave për alokimin dhe menaxhimin e kapaciteteve

3.1 Procedurat për kryerjen e fazës së shprehjes së interesit të testit të tregut, përfshirë tekstin e ftesës për shprehje interesi do të propozohen nga TAP AG brenda 20 (njëzet) ditëve prej miratimit të këtyre udhëzimeve dhe do të miratohen nga autoritetet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas marrjes së propozimit. Autoritetet do të verifikojnë, në veçanti, që procedurat të jenë të hapura, jodiskriminuese, transparente dhe në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe me legjislacionin kombëtar të vendeve pritëse.

3.2 Faza e shprehjes së interesit e testit të tregut do të kryhet nga TAP AG, e cila është përgjegjëse për zbatimin korrekt të procedurave, sikurse rezultuar prej miratimit të autoriteteve.

3.3 Aksionarët e TAP AG do të marrin pjesë në fazën e shprehjes së interesit të testit të tregut, dhe në fazën pasardhëse të rezervimit, nën të njëjtat kondita dhe kushte të zbatueshme për palët e tjera të interesuara, sikurse përcaktuar në tekstin e ftesës për shprehje interesi.

3.4 Pas përfundimit të fazës së shprehjes së interesit, autoritetet, duke marrë gjithashtu në konsideratë raportin dhe opinionin referuar në nenin 7 më poshtë, do të vlerësojnë nëse kriteret e përcaktuara me nenin 36.1 të direktivës janë përmbushur dhe, nëse po, ato do të shprehin një opinion pozitiv mbi dhënien e përjashtimit. Në shprehjen e mendimit, rëndësi do t'i jepet nga ana e autoriteteve nevojës për të vendosur kushte në përputhje me nenin 36.6 të direktivës, që kanë të bëjnë veç të tjerave, me kohëzgjatjen e përjashtimit dhe aksesin jodiskriminues në infrastrukturë, duke marrë parasysh rrethanat e veçanta kombëtare në tre vendet pritëse dhe aspektet tekniko-ekonomike të projektit TAP.

Opinionimi pozitiv mundet gjithashtu të jetë i kushtëzuar nga detyrimi që TAP AG të ofrojë kapacitetet shtesë në fazën e rezervimit dhe ta ndërtojë atë nëse është alokuar, për sa kohë është teknikisht dhe ekonomikisht e bëshme.

3.5 Nëse pas fazës së shprehjes se interesit autoritetet nuk kanë elemente të mjaftueshme për të vlerësuar nëse kriteret e nenit 36.1 të direktivës janë përmbushur dhe, për pasojë, ato nuk mundet të formulojnë një opinion për dhënien e përjashtimit, ato mundet t'i kërkojnë TAP AG ose të japë më shumë informacion ose të zbatojë fazën e rezervimit për kapacitetin e kërkuar në fazën e shprehjes së interesit.

3.6 Vendimi për përjashtim mundet të përfshijë gjithashtu detyrimin për TAP AG që të kryejë teste tregu shtesë në vitet në vijim, me qëllim vlerësimin e gatishmërisë së përdoruesve potencialë për të kontraktuar kapacitetet shtesë.

3.7 Vetëm në rast nevojë për të kryer fazën e rezervimit udhëzimet për zbatimin, projektimin e saj të detajuar dhe sasia e disponueshme e kapacitetit për rezervim do të deklarohen nga autoritetet në linjë me të njëjtat parime sikurse ky udhëzim.

3.8 Si parim i përgjithshëm:

a) në fazën e rezervimit, kapaciteti ndahet nëpërmjet ankandeve;

b) tarifat e zbatuara ndaj përdoruesve reflektojnë kostot dhe janë jodiskriminuese.

3.9 Rregullat e hollësishme, produktet, tarifat dhe kohëzgjatja e kontratave për alokimin e kapaciteteve, si dhe mekanizmat për të shqyrtuar tejkalimet e kostos dhe gjobat për t'u aplikuar ndaj TAP AG nëse kapaciteti nuk livrohet në kohë, do të vendosen nga autoritetet përpara fazës së rezervimit, duke marrë parasysh kriteret e përmendura në nenin 36.1 të direktivës, dhe rezultatet e fazës së shprehjes së interesit.

3.10 Rregullat për menaxhimin e kapaciteteve do të aplikohen në bazë të parimeve të përgjithshme të mëposhtme:

a) ato do të përfshijnë procedurat e menaxhimit të mbingarkesave (Congestion Management Procedures), marrëveshjet "Përdore ose humbe" (Use It Or Loose It), marrëveshjet për tregun sekondar të kapaciteteve, regjimet e balancimit, tejkalimet e kapacitetit (*overruns*), rregullat e nominimit dhe rinominimit në përputhje me dispozitat përkatëse të BE-së sikurse do të përgatiten, amendohen ose integrohen përmes procesit vendimmarrës (*comitology*) në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenet 6, 7 dhe 23 të rregullores 715/2009 të Parlamentit dhe të Këshillit të BE;

b) TAP AG do të përcaktojë kodin e rrjetit në përputhje me rregullat e përmendura më lart, i cili është objekt miratimi prej autoriteteve. Kodi i rrjetit do të sigurojë një regjim të harmonizuar për alokimin e kapaciteteve për të gjithë shtrirjen e projektit TAP.

#### Neni 4

#### **Njoftimi i shprehjes së interesit**

4.1 Faza e shprehjes së interesit fillon me publikimin e ftesës për shprehje interesi për alokim kapaciteti prej TAP AG një ditë pas njoftimit për miratimin zyrtar të procedurave të parashikuara në nenin 3.1. Ftesa për shprehje interesi duhet të publikohet mjaftueshëm për të tërhequr interesin e palëve të treta dhe të mundësojë pjesëmarrjen e tyre sa më të madhe.

4.2 Rrugët e përdorura për publikimin ftesës duhet të përfshijnë mediat e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare dhe *web-sitin* e TAP AG. Ftesa duhet të jetë e disponueshme në gjuhën angleze.

4.3 Ftesa duhet të japë informacion të përgjithshëm për projektin dhe për rrjedhjet për shërbimin(et) të cilat u propozohen pjesëmarrësve. Pjesëmarrësit duhet të paktën të jenë të informuar në lidhje me:

a) pikat hyrëse (in take) dhe dalëse (off take) dhe traseja e propozuar si dhe çdo alternative tjetër e projektimit nëse ekziston;

b) specifikimet teknike të propozuara të projektit, të tilla si presioni i punës dhe kushtëzimet për cilësinë e gazit, nëse ka, në çdo pikë hyrëse dhe dalëse, dhe për çdo variant projektimi në konsideratë;

c) data e parashikuar për fillimin e shërbimit (d.m.th. kur infrastruktura pritet të hyjë në punë);



d) një përshkrim i detajuar i lidhjeve të propozuara të projektit me rrjete të tjera në të tri vendet, si dhe informacion mbi mënyrën se si TAP AG do të ndjekë zgjerimin përkatës të kapaciteteve të rrjeteve të tjera për të akomoduar kapacitetin e kërkuar për TAP;

e) shërbimet e transportit të propozuara në aplikimin për përjashtim, të identifikuar me pika hyrëse (in take) dhe dalje (off take) të kontraktuara, duke specifikuar për çdo shërbim datën e fillimit dhe kohëzgjatjen.

f) shërbime transporti shtesë, që përfshijnë të paktën sa vijon:

- transport pa ndërprerje (firm) të gazit natyror në drejtimin normal prej pikës së hyrjes në Greqi (Komotini) në çdo pikë dalje (off take) tjetër në Greqi, Shqipëri dhe Itali, deri në pikën e daljes në Itali (San Foca, në afërsi të Leçes);

- transport pa ndërprerje (firm) dhe/ose me ndërprerje të gazit natyror në drejtimin e kundërt nga pika e marrjes në Itali në çdo pikë dalje (off take) tjetër në Itali, Shqipëri dhe Greqi, deri në pikën e daljes në Greqi;

g) një vlerësim jo detyrues i investimit dhe kostove operative, për kapacitete të ndryshme, të mundshme për t'u ndërtuar;

h) një përmbledhje të situatës së autorizimeve, licencave dhe miratimeve rregullatore dhe kohës së pritshme për t'i siguruar ato.

i) detaje se si mund të merret informacion për kërkesat që duhet të plotësohen për t'u pranuar nga TAP AG në lidhje me procedurat për përkujdesjen e duhur dhe sallën e të dhënave (data room) dhe në veçanti kushtet standarde kontraktuale në lidhje me paragrafin 5.1 më poshtë.

4.4 Ftesa duhet gjithashtu të përfshijë të paktën informacionin e përgjithshëm si vijon:

a) rregullimet e nevojshme për të siguruar konfidencialitetin e informacionit të marrë nga pjesëmarrësit në fazën e shprehjes së interesit;

b) një deklaratë që pjesëmarrja në fazën e shprehjes së interesit është një parakusht për pjesëmarrje në fazën e rezervimit që mund të pasojë;

c) datat e fillimit dhe përfundimit të fazës së shprehjes së interesit: data e përfundimit duhet të jetë të paktën 2 (dy) muaj pas publikimit të ftesës për shprehje interesi;

d) detajet se si duhet të paraqitet shprehja e interesit, dhe, në veçanti, një formë standarde të shprehjes së interesit.

## Neni 5

### Shprehja e interesit

5.1 TAP AG mund të përkujdeset për një procedurë të përshtatshme për hapje të kujdesshme informacioni specifik për projektin për të gjithë pjesëmarrësit, sipas një marrëveshjeje konfidencialiteti.

5.2 Konditat dhe kushtet për të pasur akses në sallën e të dhënave do të përcaktohen më tej prej TAP AG.

5.3 Në aplikimin e tyre për fazën e shprehjes së interesit, pjesëmarrësit duhet të deklarojnë se informacioni i dhënë është i vërtetë (deklarim me akt noterial).

5.4 Një pagesë pjesëmarrjeje mund të kërkohet prej TAP AG, me të vetmin qëllim për të mbuluar shpenzimet administrative të fazës së shprehjes së interesit. Përshtatshmëria e tarifës është pjesë e vlerësimit të autoriteteve sipas pikës §3.1.

5.5 Informacioni duhet të jepet në sallën e të dhënave të TAP AG për produktet e ofruara në sistemet e gazit natyror në vendet pritëse. Për sa i përket Italisë lidhja me OST (Snam Rete Gas) bëhet në përputhje me instruksionet e Autorità per l'Energia Elettrica e il Gaz ARG / gaz 2/2010. Për sa i përket Greqisë, lidhja me sistemin e transmetimit kombëtar të gazit, në pronësi dhe operator DESFA SA, bëhet në bazë të dispozitave të ligjit 4001/2011 (FEK 179, 2011/08/22) dhe të Kodit të Rrjetit (vendimi RAE No. 1096/2011, ΦΕΚ Β '2227, 2011/04/01 ndryshimin e vendimit ministror Δ1/A/5346/22.03.2010, ΦΕΚ Β' 379/01.04.2010). Për sa i përket Shqipërisë në përputhje me ligjin për sektorin e gazit natyror nr. 9946 dt. 30/06/2008.

## Neni 6

### Pjesëmarrja në fazën e shprehjes së interesit

6.1 Në fazën e shprehjes së interesit, TSO dhe institucionet përkatëse (qeveritë, ministrinë e vendeve anëtare dhe joanëtare të BE, institucionet financiare), sikurse operatorët e tregut do të ftohen të informojnë autoritetet në lidhje me interesin e tyre në infrastrukturë, sikurse për planet e zhvillimit të transportit të gazit në rajon.

6.2 Pranimi i pjesëmarrjes së operatorëve të tregut në fazën e shprehjes së interesit mund të kushtëzohet me kërkesa të arsyeshme të besueshmërisë bankare (creditworthiness)

6.3 Kur të shprehin interesin e vet, pjesëmarrësit duhet të tregojnë, të paktën:

- a) shërbimet e transportit për të cilët ata janë të interesuar;
- b) tipi (pa ndërprerje/me ndërprerje), data e fillimit, kohëzgjatja dhe sasia e kapacitetit për çdo shërbim;

Pjesëmarrësit në fazën e shprehjes së interesit duhet të lejohen të paraqesin kërkesa me datë fillimi dhe kohëzgjatje të ndryshme për shërbimet që kërkojnë, brenda kuadrit të përgjithshëm të datave korresponduese të propozuara nga TAP AG.

6.4 Pjesëmarrësit nuk duhet ta konsiderojnë veten të kufizuar në gjurmën (rrugën) e propozuar dhe për këtë arsye, në rast se ata janë të interesuar në shërbime të tjera nga ato të specifikuar në ftesën për shprehje interesi, ata mund të tregojnë modifikimet e përshtatshme për propozimin e TAP AG-s që do të mund t'u përshtatej më mirë nevojave të tyre, të tilla si:

- a) pika hyrëse (intake) dhe dalëse (offtake) shtesë për t'u ndërtuar përgjatë gjithë rrugës së propozuar të tubacionit apo të lokalizuara diku tjetër nga ato të projektit origjinal;
- b) data të fillimit dhe mbarimit ose kohëzgjatje të ndryshme të shërbimit të transportit;
- c) shërbime të ndërprershme.

Pjesëmarrësit duhet të tregojnë gjithashtu shtrirjen e efektit të modifikimeve të kërkuara, të tilla si për të shërbyer vendet në afërsi të rrugës së propozuar të projektit, nga pika të tjera hyrëse dhe dalëse.

6.5 Operatorët e tregut duhet të paraqesin kërkesën e tyre tek TAP AG dhe një kopje tek autoritetet, duke përfshirë një deklaratë për TAP AG se nuk do të futet dhe nuk do të transportohet gaz objekt sanksionesh në asnjë pjesë të projektit TAP. Vetëm në kopjen për autoritetet, aplikantët duhet të shtojnë informacionin e mëposhtëm:

- a) sistemet transportuese në rrjedhën sjellëse (upstream) dhe në rrjedhën konsumuese (downstream) tek të cilat ata do të mbështeten;
- b) nëse ata tashmë kanë kapacitet të rezervuar në këto sisteme apo kontrata transporti që përputhen me kapacitetet e kërkuara;
- c) burimi dhe origjina e gazit; në veçanti, aplikantët duhet të deklarojnë nëse kapaciteti i kërkuar është me qëllim që të transportojë gaz nga faza II e vendburimit Shah Deniz;
- d) Statusi i marrëveshjeve me furnizuesit në rrjedhën sjellëse (upstream) (tashmë në fuqi, memorandum mirëkuptimi, të tjera).

6.6 OST-ekzistuese dhe institucionet që marrin pjese në fazën e shprehjes së interesit duhet të shprehin interesin e tyre tek autoritetet dhe te TAP AG.

6.7 Për të shmangur çdo dyshim, çdo detyrim i mëtejshëm, përveç atyre të përcaktuara në këtë rregullore, nuk mund t'i imponohet pjesëmarrësve në fazën e shprehjes së interesit.

## Neni 7

### Raportimi i TAP AG mbi rezultatet e fazës së shprehjes së interesit

7.1 Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas përfundimit të fazës së shprehjes së interesit, TAP AG do t'i dorëzojë autoriteteve një raport që përmbledh rezultatet e fazës së shprehjes së interesit, përfshirë vlerësimin e tij për rezultatet e fazës së shprehjes së interesit, duke iu referuar në mënyrë specifike implikimeve që ajo ka në projekt. Vlerësimi i TAP AG nuk është detyrues për opinionin që do të jepet nga autoritetet sipas paragrafit 7.2.



7.2 Të tre autoritetet do të japin opinionin e tyre rreth fazës së shprehjes së interesit brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes së raportit përmbledhës të përmendur në nenin 7.1.

**VENDIM**  
**Nr. 62, datë 13.4.2012**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR**  
**“TV ORA NEWS”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor privat “Tv Ora News”, në fushën e transmetimeve televizive private vendore.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.  
Ky vendim i shtrin efektet nga data 28.1.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr. 63, datë 13.4.2012**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR**  
**“RADIO KISS”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Kiss”, në fushën e transmetimeve radiofonike private vendore.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.  
Ky vendim i shtrin efektet nga data 27.2.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr. 64, datë 13.4.2012**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR**  
**“RADIO SPARTAK SM”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Spartak SM”, në fushën e transmetimeve radiofonike private vendore.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.  
Ky vendim i shtrin efektet nga data 27.2.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 21.5.2012  
Doli nga shtypi më 23.5.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2012

Çmimi 42 lekë